



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 451 Akti**

**Nr. 555 Vendimi**  
**Tiranë, më 22.7.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, zj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 20.7.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0, salla B, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Alfred Sali**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit Alfred Sali, vëzhguesen ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike, në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Alfred Sali, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Alfred Sali, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët: Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short, komisioneri Olsi Komici.
3. Me vendimin nr. 1, datë 9.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Alfred Sali, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.
4. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP).
6. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.
7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 29.6.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Alfred Sali bazuar në të tria kriteret, njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative.
8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 30.6.2022 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përftuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
9. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar nëpërmjet *e-mail*-it në datën 15.7.2022, prapësimet dhe provat pranë Komisionit, në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.
10. Komisioni, nëpërmjet postës elektronike në datën 18.7.2022, njoftoi subjektin për seancën dëgjimore të datës 20.7.2022 (ora 10:00).

## II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, në lidhje me diskutimin e rezultateve të hetimit për të tria kriteret, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 20.7.2022 (ora 10:00), në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

12. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, si dhe parashtrori shpjegimet e tij, të cilat i kishte dërguar më parë me shkrim nëpërmjet *e-mail* pranë Komisionit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Alfred Sali kërkoi konfirmimin në detyrë.

## III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Z. Alfred Sali ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, ka dhënë shpjegime për të gjitha problematikat, për të cilat Komisioni i ka ngarkuar barrën e provës.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

15. Për subjektin e rivlerësimit Alfred Sali, bazuar në nenin 179/b Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr.84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

16. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

**ILDKPKI-ja** ka dërguar aktin<sup>1</sup> e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit Alfred Sali, nga ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

---

<sup>1</sup>Akt kontrolli nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2019.

Në deklaratën e pasurisë (në vijim deklarata *Vetting*) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 29.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri (të luajshme dhe të paluajshme):

❖ **Pasuritë e subjektit të rivlerësimit**

**1. Automjetet i markës “Mercedes-Benz”. Kontratë blerje nr. \*\*\*, datë 22.2.2012. Vlera: 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhura (kursime) nga paga.**

**1.1** Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “*Blerë automjeti ‘Mercedes-Benz’, tip \*\*\*, viti prodhimit 2000. Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 22.2.2012. Vlera: 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursime*”.

**1.2** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, si nga DPSHTRR-ja<sup>2</sup> ashtu dhe nga subjekti, rezulton se shtetasi D. Xh., i cili e ka blerë automjetin me kontratë shitblerje<sup>3</sup> në datën 23.6.2010, me çmim 9.000 euro, ia shet subjektit të rivlerësimit me kontratë shitblerje<sup>4</sup>, datë 22.2.2012, me çmimin 400.000 lekë.

**1.3** Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetasit D. Xh., por nuk rezultoi<sup>5</sup> ndonjë situatë e tillë. Gjithashtu, edhe nga verifikimet në sistemin *TIMS* dhe AMF nuk rezultojnë të dhëna që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë përdorues i automjetit para datës së blerjes së automjetit.

**1.4** Në DIPP-në e vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e automjetit kursimet, ndërsa në pyetësoin nr. 1 ka deklaruar të ardhurat nga shitja e një automjeti më parë në datën 3.4.2009.

**1.5** Nga leximi i DIPP-ve rezulton se subjekti ka deklaruar shtesë kursimesh në vitin 2009 në shumën 400.000 lekë, por si burim të kësaj shtese ai ka deklaruar të ardhurat nga pagat dhe jo të ardhurat nga shitja e mjetit. Në përgjigjet e pyetësoit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi prej tij në DIPP-në e vitit 2009 i të ardhurave nga shitja e mjetit në shumën 400,000 lekë si kursime në banesë, ka ndodhur për shkak të pakujdesisë. Gjithashtu, në vitin 2012, kur subjekti ka blerë automjetin, nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve.

**1.6** Lidhur me mundësitë financiare për blerjen e automjetit e llogaritur në vlerën 400,000 lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* rezulton se ai ka pasur mundësi për krijimin e pasurisë, për sa kohë ka pasur të disponueshme edhe një gjendje *cash* nga viti paraardhës.

**1.7** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një çmim fiktiv të blerjes së këtij automjeti, për sa kohë që brenda një viti e gjysmë, nga data kur shitësi e bleu automjetin në vlerën 9.000 euro, ia shiti subjektit me një vlerë më të vogël se gjysma e çmimit të blerjes (400.000 lekë).

---

<sup>2</sup>Shkresë nr. \*\*\* datë, 14.2.2020, të DPRSHTRR-së.

<sup>3</sup>Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 23.6.2010.

<sup>4</sup>Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 22.2.2012.

<sup>5</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.8** Në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se nga Komisioni nuk është marrë në konsideratë: (i) gjithë historiku i transaksioneve të kryera mbi këtë automjet që prej importimit të tij; (ii) vleftha e deklaruar për çdo shitblerje; (iii) gjendja e mjetit; si dhe (iv) norma e amortizimit.

**1.9** Në lidhje me arsyet (i) dhe (ii), subjekti shpjegon se për automjetin janë kryer 6 transaksione shitblerjeje<sup>6</sup> që prej momentit të importimit në Republikën e Shqipërisë deri për 3 vjet e 9 muaj, çka provon se asnjë prej blerësve nuk ka qenë i kënaqur me automjetin, për shkak të problemeve të karakterit teknik që i ka hasur edhe subjekti, çka ka sjellë, rrjedhimisht, edhe një çmim të ulët shitblerjeje.

**1.10** Subjekti shpjegon se e ka blerë automjetin në vlerën 400.000 lekë, prej shitësit D. Xh. në tregun informal të makinave, ku automjeti shitej për arsye emigrimi.

**1.11** Në lidhje me problemet teknike të automjetit (iii), subjekti ka shpjeguar në prapësime se 2-3 muaj pasi ka blerë automjetin janë shfaqur disa herë probleme të karakterit elektrik në sistemin e ndezjes dhe të furnizimit me karburant dhe i është bërë me dije nga specialistët se këto problematika kanë qenë të hershme në kohë. Në këtë kohë ka kuptuar edhe arsyen se përse automjeti i është shitur me çmim të ulët. Problemet e karakterit elektrik vërtetohen edhe në pjesën arsyetuese të vendimit të pushimit, datë 18.4.2013, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, për ngjarjen e datës 13.3.2013, pra, 1 vit pas blerjes (procedimi nr. \*\*\*, i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ).

**1.12** Në lidhje me normën e amortizimit (iv), subjekti shpjegon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë normën e amortizimit të automjetit prej 5% në vit, për të cilën ka parashikim ligjor, që është pranuar tashmë si e tillë në jurisprudencën e Komisionit (mbajtur në konsideratë neni 22/5, germa “b” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar).

**1.13** Në përfundim, për sa më lart, subjekti pretendon se ka deklaruar një çmim real të blerjes së këtij automjeti prej tij.

## **Vlerësimi i Komisionit**

**1.14** Komisioni, në një analizë tërësore të dokumentacionit të administruar, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, i konsideron ato të mjaftueshme për të krijuar bindjen se vlera e blerjes së automjetit prej 400.000 lekësh, e deklaruar prej tij, është reale.

**Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, i blerë në datën 22.2.2012, në vlerën 400.000 lekë, nuk paraqiten problematika.**

**2. Të drejtë përdorimi (qiramarrës) mbi një apartament me sip. 110.8 m<sup>2</sup>, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në ZVRPP-në Vlorë. Kontratë qiraje verbale (20.000 lekë/muaj) prej vitit 2014 e në vijim, lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë, në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.**

---

<sup>6</sup>Referuar dosjes së DPSHTRR-së, rezulton se: automjeti është blerë prej shtetasit L. F. në datën e mbërritjes më 2.6.2008, në Shqipëri, me vlerë 1.056.831 lekë dhe ia ka shitur në datën 24.7.2008, shtetasit Gj. A. në vlefthën prej 490.000 lekësh; në datën 1.12.2008, shtetasi Gj. A. ia shet automjetin blerësit A. Xh. në vlerën 500.000 lekë; në datën 14.5.2009, shtetasi A. Xh. ia shet automjetin blerësit K. H. në vlerën 15.000 euro; në datën 23.6.2010, shtetasi K. H. ia shet automjetin blerësit D. Xh. në vlerën prej 9.000 euro; në datën 22.2.2012, shtetasi D. Xh. ia shet automjetin blerësit Alfred Sali në vlerën 400.000 lekë; në datën 24.9.2019, shtetasi Alfred Sali ia shet automjetin blerësit M. Xh. në vlerën 1.000 euro.

**2.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Pagesë për qira banese, në Vlorë, shuma 20.000 lekë/muaj”.

**2.2** Në DIPP-në e vitit 2016<sup>7</sup>, subjekti ka deklaruar: “Të drejta reale (qiramarrës) mbi një apartament, kulla “\*\*\*” nr. \*\*\*, lagjja “\*\*\*”, Vlorë. Marrëveshje verbale. Personi juridik “\*\*\*” sh.p.k., administrator E. F., qiradhënës”.

**2.3** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 6.4.2011, për apartamentin e mësipërm, i ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Vlorë, në emër të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.; dhe (ii) kopje të kartelës së pasurisë dhe hartës treguese.

**2.4** Në pyetësin standard, subjekti ka depozituar vërtetimin datë 29.1.2020 të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., e cila konfirmon se subjekti, sipas një marrëveshje verbale midis tyre, banon në apartamentin nr. \*\*\*, kati \*\*\*, në kullën “\*\*\*”, lagjja “\*\*\*”, Vlorë, me qira mujore 20.000 lekë/muaj.

**2.5** Komisioni vëren se në DIPP-të nga viti 2014 e në vijim subjekti ka deklaruar adresë banimi lagjen “\*\*\*”, Vlorë, por nuk ka deklaruar marrëveshje/kontrata qiraje për këtë pasuri të cilën ai e ka zotëruar. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar marrëdhënien e qirasë për herë të parë në deklaratën *Vetting*, si dhe në DIPP-në e vitit 2016 të dorëzuar në ILDKPKI pas deklaratës *Vetting*. Subjekti ka depozituar vërtetimin e datës 29.1.2020 nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.

**2.6** Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe administratorëve e ortakëve të saj, por nuk rezultoi<sup>8</sup> ndonjë situatë e tillë.

**2.7** Nga hetimi në faqen *online* të ASHK-së, ky apartament rezultoi se në pronësi të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, për sa duket se marrëdhënia e subjektit me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. nuk është një marrëdhënie qiraje, por është një marrëdhënie huapërdorjeje pa kundërshtpërblim. Veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit me plotësimin e deklaratës *Vetting* e në vijimësi, duken të tilla për të fshehur këtë marrëdhënie huapërdorjeje midis subjektit dhe shoqërisë tregtare “\*\*\*” sh.p.k.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**2.8** Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se ka pasur marrëveshje qiraje verbale 1-vjeçare, me personin juridik “\*\*\*” sh.p.k., për apartamentin me sipërfaqe 110.8 m<sup>2</sup> në pronësi të saj, kundrejt vlerës 20.000 lekë/muaj. Kjo marrëveshje është ripërtërirë çdo vit. Pra, në kushtet e nenit 803 të Kodit Civil që parashikon se *kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë*, nuk është lidhur kontratë për marrje me qira të sendit mes tij dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., ku ai ka banuar në lagjen “\*\*\*”, Vlorë.

**2.9** Në vijim, subjekti shpjegon se provat e administruara provojnë: *së pari* se e drejta e përdorimit të sendit është kundrejt shpërblimit, çka e klasifikon marrëdhënien si qiramarrje; *së dyti* pagesat janë kryer *cash* (nuk ekziston asnjë parashikim ligjor që ato të kryhen në rrugë bankare), fakt që vërtetohet nga deklaratimet e palëve të përfshira në këtë marrëdhënie, por dhe qëndrueshmëria e saj në kohë; *së treti*, sikurse është vërtetuar nga Komisioni nuk ekziston mes subjektit dhe administratorit/ administratores të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. asnjë situatë konflikti

<sup>7</sup>Plotësuar/dorëzuar në mars të vitit 2017.

<sup>8</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjrokastër dhe nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

interesi, që kjo pasuri t'i lihej subjektit për përdorim pa kundërshtëpërblim, çka do të binte në kundërshtim edhe me logjikën e tregut.

**2.10** Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar: (i) vërtetimin datë 29.1.2020 të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., që konfirmon se subjekti banon në apartamentin nr. \*\*\*, kati \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, në kullën “\*\*\*\*”, me qira 20.000 lekë/muaj; (ii) vërtetimin datë 2.7.2021 të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., që konfirmon përmbajtjen e vërtetimit datë 29.1.2020 dhe se në janar të çdo vit është bërë marrëveshje verbale mes palëve, por që citon se subjekti ka banuar në këtë apartament për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2020.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**2.11** Në lidhje me shpjegimet e subjektit, Komisioni merr në konsideratë pretendimet e tij se marrëdhënia e qirasë ka qenë 1-vjeçare dhe është ripërtëritë çdo vit, prandaj në kushtet e nenit 803 të Kodit Civil nuk ka pasur detyrimin që kontratën e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit ta formalizonte me shkrim, por kjo nuk e përjashton subjektin nga detyrimi ligjor, sipas ligjit nr. 84/2016 për të deklaruar, ndër vite, të drejtën reale “të përdorimit” të një pasurie të paluajtshme (përdorim nëpërmjet marrëdhënies së qirasë). Mosdeklarimi “i përdorimit” të një pasurie me qira (apo me huapërdorje) në deklaratat periodike vjetore, nuk ka lidhje me vlerën e qirasë nën limitin ligjor për t’u deklaruar si shpenzim, siç pretendon subjekti në shpjegime. Objekti i deklarimit (pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato) nga subjektet deklarues përcaktohet edhe në formularët e deklaratave periodike të deklarimit të pasurive, përfshirë edhe vitet 2014 e në vijim kur subjekti pretendon se ka pasur marrëdhënie qiraje, ndërsa nga ana tjetër neni 21 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, përcakton: *“Deklarimi i pasurive bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm”*.

**2.12** Nisur nga fakti i mospërbushjes së këtij detyrimi ligjor, nga fakti që subjekti nuk provoi ekzistencën e marrëdhënies së qirasë (nuk paraqiti asnjë dokument ligjor për të provuar këtë marrëdhënie), nga vërtetimi datë 2.7.2021 i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (paraqitur në prapësime), që konfirmon se subjekti ka banuar me qira në apartamentin e saj për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2020, shpjegimet e subjekti nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse, prandaj, Komisioni arrin në përfundimin se marrëdhënia e subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2014 – 1.1.2017, nuk është një marrëdhënie qiraje, por është një marrëdhënie huapërdorjeje pa kundërshtëpërblim. Veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit me plotësimin e deklaratës *Vetting* e në vijimësi, duken të tilla për të fshehur këtë marrëdhënie huapërdorjeje midis subjektit dhe shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **3. Depozitë kursimi në “Raiffeisen Bank”, në emër të vajzës së subjektit (J. A. S.). Vlera: 446.091,55 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: nga paga.**

**3.1** Kjo depozitë është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2011, në vlerën 60.000 lekë dhe më pas janë deklaruar shtesat ndër vite.

**3.2** “Raiffeisen Bank”, me vërtetimin e datës 25.1.2017, konfirmon këtë depozitë kursimi në emër të shtetasës J. S., e hapur në datën 14.2.2011, me vlerë 66.228 lekë dhe me gjendje 446.091 lekë në datën 25.1.2017, me burim krijimi të ardhurat nga paga e subjektit.

### **Komisioni nuk konstatoi problematikë në lidhje me këtë pasuri.**

**4. Shuma prej 58.000 euro, dhënë hua shtetasit L. S. (babai i subjektit), kontratë verbale, pa afat, me qëllim përfundimin e punimeve të ndërtimit, për pajisjen me akt kolaudimi, leje shfrytëzimi, pagim detyrimesh tatimore dhe regjistrim në ZVRPP (shihni deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., datë 26.1.2017). Objekti banesë Lagjja Nr. \*\*\*, Sarandë, leje**

**ndërtimi vendim i KRRT-së, Bashkia Sarandë (nr. \*\*\*, datë 7.10.2006 e papërfunduar). Vlera: 58.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: lojëra fati *online*.**

**5. Likuiditete *cash* në monedhë euro. Vlera: 9.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: lojëra fati *online*.**

Lidhur me deklaratimet e subjektit për këto dy pasuri, të cilat kanë burim (të njëjtë) “të ardhurat nga lojëra e fatit” të deklaruara prej tij në DIPP-në e vitit 2014, Komisioni kreu fillimisht hetim në lidhje me këto të ardhura dhe burimin e krijimit të tyre (pasuria 4 dhe 5).

- Nga hetimi, Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga lojë fati online [www.\\*\\*\\*.com](http://www.***.com). Adresa e shoqërisë “\*\*\* (\*\*\*)\*\*\*: Zyrë regjistrimi: \*\*\*, \*\*\*, England U.K. Company no. \*\*\*, \*\*\*: \*\*\*, Registered in \*\*\* with company no:\*\*\*. Shuma e fituar 79.027,5 euro. Prej “Raiffeisen Bank”, në datën 19.3.2014, në llogarinë nr. \*\*\* është tërhequr shuma 75.854 euro. Është kryer vetëdeklarim pranë DRT-së Vlorë, si subjekt i ligjit nr. 8438/1198 për shumën e tatimit të llogaritur 1.111.462 lekë (7.900 euro) dhe është paguar detyrimi tatimor. Shuma 79.027,5 euro”.*

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*<sup>9</sup> disa dokumente, midis të cilave: (i) kthim përgjigje datë 25.10.2016, nga “\*\*\*”, ku kjo kompani mbështetur në kërkesën e subjektit të rivlerësimit ka dërguar një statement bankar që tregon tërheqjen e fondeve, por shpjegon se nuk mund të ofrojë informacion lidhur me fitimin e lojës. Statement bashkëngjitur kësaj përgjigje, tregon tri transferta në llogarinë e lojtarit “\*\*\*” në datën 27.2.2014 në vlerat 40000.00; 33000.00; 3000.00. Nga lëvizjet vërehet se nga karta e kreditit të subjektit<sup>10</sup> janë depozituar në llogarinë e lojtarit shuma të ndryshme me vlerë totale 1.080 euro; (ii) e-mail i datës 27.2.2014 nga adresa e postës elektronike \*\*\* me dërgues “\*\*\*”, ku konfirmohet se lojtari ka fituar *Jackpot* në lojën \*\*\* në shumën 65.059,27 GBP, e cila do të kalojë në llogarinë në euro të lojtarit; (iii) mandat bankar, datë 19.3.2014, për tërheqjen nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, të shumës 75.854 euro; (iv) deklaratë individuale (DIVA) e të ardhurave të përfituara nga tatimpaguesi Alfred Saliu për vitin 2014, ku subjekti ka deklaruar përfitimin e të ardhurave nga lojëra fati në shumën bruto prej 11.063.850 lekësh.

- Në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga lojëra fati online. [www.\\*\\*\\*.com](http://www.***.com). Adresa e shoqërisë “\*\*\*: ... Shuma është tërhequr në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 19.3.2014, në llogarinë nr. \*\*\*. Shuma është 79.027 euro”.*

- Komisioni vëren se ka mospërputhje deklarimi në lidhje me të ardhurat e fituara nga lojërat e fatit sepse: (i) nga shkresa e kompanisë “\*\*\*”, datë 25.9.2016, konfirmohet se subjekti ka fituar *Jackpot* në shumën 75.000 euro; (ii) nga nxjerrja e llogarisë bashkëngjitur nga kompania “\*\*\*” rezulton se nga llogaria e subjektit janë kryer me tri transaksione, tërheqje në shumën totale 76.000 euro; (iii) nga korrespondenca elektronike, datë 27.2.2014, e paraqitur nga subjekti rezulton se ka përfituar *Jackpot* në shumën 65.059 GBP, e konvertuar në shumën 79.027 euro; si dhe (iv) nga tërheqja e datës 19.3.2014 e kryer nga subjekti në “Raiffeisen Bank” është tërhequr shuma 75.854 euro.

- Subjekti ka shpjeguar në pyetësorin nr. 3 se në kompaninë “\*\*\*” është fituar shuma 65.059 GBP e konvertuar në shumën 79.027 euro dhe ka tërhequr në llogarinë e tij shumën prej 76.000 euro, ndërsa diferenca në shumën prej 3.027 euro ka mbetur në llogarinë e tij të asokohe, pranë

<sup>9</sup>Shkresën e subjektit drejtuar kompanisë “\*\*\*” United Kingdom për konfirmimin e fitimit të lotarisë në shkurt të vitit 2014, si dhe mandat pagesat për dërgim zarfi në postë datë 21.10.2016; pasqyrë e basteve të vëna në llogarinë *online* të kompanisë “\*\*\*”, më 25.2.2014 (shihni dosjen e ILDKPKI - Aneks nr. 4/4).

<sup>10</sup>Llogari në valutë për tërheqje me Master Card me nr.\*\*\*, e konfirmuar nga “Raiffeisen Bank”.



kësaj kompanie. Pas mbajtjes së komisionit bankar nga “Raiffeisen Bank” për transfertën, ka tërhequr shumën prej 75.854 euro, ku shuma prej 854 euro është depozituar në të njëjtën ditë, në llogarinë e tij të kartës së kreditit.

- Nga veprimet bankare në “Raiffeisen Bank”<sup>11</sup> konfirmohen pagesa të kryera nga subjekti me përfitues, sipas përshkrimit MC \*\*\*, për vitet: 2012 - shuma 1.575 euro; 2013 - shuma 1.405 euro; 2014 - shuma 1.758 euro; 2015 - shuma 554 euro; 2016 - shuma 809 euro.

- DPPP-ja konfirmon<sup>12</sup> se shtetasi Alfred Sali në datën 19.3.2014 ka tërhequr nga llogaria shumën prej 75.854 euro (llogaria nr. \*\*\*, në “Raiffeisen Bank”). Në lidhje me burimin e këtyre fondeve, nisur nga shuma e transaksionit, është investiguar pranë bankës, nga ku ka rezultuar se është përfituar një transfertë nga Anglia në shumën 75.860 euro nga subjekti “\*\*\*”, i cili i përket një kompanie bastesh. Si burim fondesh ka deklaruar “*të ardhura personale nga një shoqëri në Londër*”.

- Subjekti rivlerësimi ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2017: “*Pagim detyrimi tatimor në vlerën 1.250.000 lekë pranë DRT-së Vlorë, si subjekt i ligjit nr. 8438/1998 (viti 2014 shihni DIPP-në 2015). Shuma e detyrimit të llogaritur 1.111.462 lekë (7.900 euro + interesat deri në datë 11.1.2017. Burimi i krijimit të shumës, e ardhur nga lojë fati online (krijuar vitit 2014, shihni DIPP-në 2015). Pjesa takuese: 100%*”.

- Drejtoria Rajonale Tatimeve Vlorë konfirmon<sup>13</sup> se subjekti është regjistruar pranë kësaj drejtorie në datën 28.4.2015 dhe më 30.4.2015 ka deklaruar të ardhura *bruto* nga lojëra fati shumën 11.063.850 lekë, si dhe ka paguar për këtë shumë tatimin në shumën 1.250.000 lekë në datat 27.1.2017 dhe 30.1.2017.

- Në pyetësin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të depozitojë kopjen e dokumentit bankar për pagesën e tatimit në burim të deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2014. Subjekti në përgjigje ka shpjeguar se deklarimi në lidhje me këtë pagesë detyrimi tatimor është kryer *online* në faqen zyrtare të DPT-së Vlorë dhe pagesat në lidhje me këtë detyrim janë kryer në vlerën 1.250.000 lekë, sipas dy faturave përkatëse në datat 27.1.2017 dhe 28.1.2017 (më 30.1.2017), në “Raiffeisen Bank”.

- Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar dokumentet që provojnë shpjegimet e tij<sup>14</sup>.

Referuar deklaramit të subjektit në DIPP-në e vitit 2017, burim krijimi i vlerës 1.250.000 lekë të paguar si detyrim tatimor mbi të ardhurat nga lojërat e fatit, janë “*të ardhura nga lojëra fati online*”. Rezulton se që nga DIPP-ja e vitit 2014 e në vijim, subjekti nuk ka deklaruar as gjendje *cash* të kësaj shume apo të shumës së fituar në lojëra fati, si dhe as pakësim të gjendjes *cash* në vitin 2017 (në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2017), rrjedhimisht, duket se vlera 1.250.000 lekë e paguar si detyrim tatimor nuk mund të ketë pasur si burim “*të ardhura nga lojëra fati online*”.

- Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar, ndër vite, destinacionin e shumës 75.854 euro të tërhequr nga llogaria e tij në datën 19.3.2014. Nga leximi i deklaratave periodike, Komisioni vëren

<sup>11</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>12</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2017, e DPPP-së drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>13</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2012 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2022, të DRT-së Vlorë.

<sup>14</sup>Urdhër pagesën “Për tatimin mbi të ardhurat individuale”, datë 11.1.2017, në datë 27.1.2017, për shumën totale të detyrimit 1.482.314 lekë dhe detyrimin e paguar 850.000 lekë; urdhër pagesën “Për tatimin mbi të ardhurat individuale”, datë 27.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, datë 28.1.2017, për shumën totale të detyrimit 1.485.587 lekë dhe detyrimin e paguar 400.000 lekë, bashkëlidhur mandati bankar, datë 30.1.2017, për pagesën e shumës 400.150 lekë (400.000 + 150 komision) të kryer nga subjekti në favor të DPT-së për tatimin mbi të ardhurat individuale për vitin 2014.

se të ardhurat nga lojërat e fatit nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në DIPP-të për vitet 2014, 2015 dhe 2016 (shitesa apo pakësime).

- Në procesverbalin e datës 11.1.2016 para ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se ka vlerësuar që shuma e disponuar *cash* prej tij (e fituar në lojë fati) të ruhej e paprekur nga familja dhe është mbajtur prej tij në banesë në gjendje *cash*, me qëllim kryerjen e ndonjë investimi të mëvonshëm, për të cilin nuk kanë gjetur ndonjë ofertë. Subjekti ka dhënë të njëjtin shpjegim edhe për Komisionin në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket e dyshimtë transferata e shumës 75.860 euro në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, për sa kohë që nuk provohet dërgimi i saj nga llogaria e lojtarit, si dhe nisur nga tërheqja e saj menjëherë, nga mosshlyerja e detyrimeve tatimore në kohën e përfitimit (pagimi i tyre duket se është bërë për efekt të deklaratës *Vetting* dhe duket se shuma 1.250.000 lekë e paguar si tatim mbi të ardhurat nga lojërat e fatit nuk mund të ketë si burim krijimi këto të ardhura), nga mosdeklarimi i destinacionit të shumës së tërhequr për të gjithë periudhën deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*. Deklarimi i subjektit, për huan në shumën prej 58.000 euro dhënë babait të tij, duket i dyshimtë dhe nuk është në harmoni/përputhshmëri me deklaratimet e tij, ndër vite, apo në lidhje logjike e ekonomike me investimin e kryer/pretenduar nga babai i tij (trajtuar në vijim të vendimit).

Vlera prej 75.854 euro e tërhequr nga gjendja e llogarisë bankare dhe e pretenduar se është mbajtur në banesë nga subjekti nuk vjen në harmoni me situatat e deklaruara nga subjekti në DIPP-të 2014 – 2016, ku rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë marrë kredi bankare për nevoja familjare, si dhe kredi për të shlyer një kredi tjetër (trajtuar në vijim ).

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

- Në prapësimet e tij, në lidhje me konstatimin se *duket e dyshimtë transferata e shumës prej 75.860 euro në llogarinë e subjektit, për sa kohë nuk provohet dërgimi i saj nga llogaria e lojtarit si dhe nisur nga tërheqja e saj menjëherë*, subjekti ka shpjeguar se sikurse ka rezultuar në fazën e hetimit administrativ, nga statement i ‘Raiffeisen Bank’ në datën 10.3.2014 (datë dërgimi) prej llogarisë /\*\*\* \*\*\*, në llogarinë e tij në këtë bankë, është transferuar shuma prej 75.860 euro me Wire Transfer (për të cilën është mbajtur si komision prej bankës dërguese, vlefte prej 140 euro). Në datën 19.03.2014 subjekti ka tërhequr në “Raiffeisen Bank”, dega Vlorë, shumën 75.854 euro (ku shuma prej 6 euro është mbajtur si komision nga kjo bankë). Në vijim shuma 854 euro është depozituar në të njëjtën datë në llogarinë e kartës së kreditit të subjektit (mandati, datë 19.3.2014, në “Raiffeisen Bank”, dega Vlorë).
- Shoqëria \*\*\* (\*\*\*) / \*\*\*/ me adresë \*\*\* U. K., në rregulloren e saj, parashikonte/ka parashikuar se depozitimi i pagesave dhe tërheqja e shumave të fituara, kryhet vetëm në një llogari të klientit dhe nuk lejon hapjen e më shumë se një llogarie për të njëjtin klient, si dhe nuk operon me llogari të dyfishta bankare. Në raste fitimi, shuma përkatëse kalon pas procedurave të verifikimit, në llogarinë bankare nga e cila janë bërë pagesat/derdhjet, duke vepruar me referenca përkatëse.
- Në vijim, në lidhje me provueshmërinë e fitimit të shumës nga loja e fatit dhe transfertës së kryer në lidhje me të, subjekti ka shpjeguar në prapësime se komunikimi me kompaninë \*\*\* është bërë nëpërmjet llogarisë së krijuar prej tij pranë saj dhe çdo komunikim elektronik mban numrin e referencës përkatëse \*\*\*. Shuma e fituar është 79,027.50 euro, çka konfirmohet nga bileta përkatëse (administruar si provë), si dhe për shumën e fituar është vënë në dispozicion bileta përkatëse printuar nga [https://\\*\\*\\*History](https://***History) dhe nga e-mail datë 27.2.2014. Transferata e shumës së

fituar është bërë në të njëjtën llogari, llogarinë e subjektit (të kartës së kreditit) me nr. \*\*\*, në “Raiffeisen Bank”, dega Vlorë, llogari prej së cilës janë bërë edhe pagesat në drejtim të kësaj shoqërie. Transferta rezulton të jetë hetuar administrativisht nga autoritetet shqiptare dhe nga DPPP-ja, sikurse rezulton edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2017, e saj. Në DIVA-n e të ardhurave të përfituara nga subjekti për vitin 2014 është deklaruar përfitimi i të ardhurave nga lojëra fati dhe është paguar dhe tatimi mbi të ardhurat më vonë.

Për sa më lart, subjekti pretendon se provohet plotësisht që e ardhura është fituar dhe transferta është reale.

- Për të provuar sa më lart, subjekti ka depozituar të njëjtat prova që ka depozituar bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, duke përshtuar dhe përmbajtjen e tyre, si dhe ka dhënë të njëjtat shpjegime si gjatë pyetësorëve. Në vijim, subjekti shpjegon se të gjitha komunikimet me kompaninë në lidhje me shumën e fituar dhe tërheqjen e saj (*e-mail* dhe korrespondencë shkresore) janë bërë në emrin dhe mbiemrin e subjektit.
- Në lidhje me konstatimin e Komisionit se *tërheqja e shumës 75,860 euro është kryer menjëherë...*, subjekti shpjegon se nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor në lidhje me mënyrën e disponimit të të ardhurës në bankë ose jashtë saj dhe as detyrim ligjor për vleftën *cash* që duhet të mbahet jashtë sistemit bankar, në këndvështrim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, për sa kohë që subjekti është deklarues që prej vitit 2004 dhe jo deklarues për herë të parë.
- Për sa i përket konkluzionit të Komisionit për *moshlyerjen e detyrimeve tatimore në kohën e përfutimit (pagimi i tyre duket se është bërë për efekt të deklaratës Vetting dhe duket se shuma 1.250.000 lekë e paguar si tatim mbi të ardhurat nga lojërat e fatit nuk mund të ketë si burim krijimi këto të ardhura)*, subjekti ka shpjeguar se meqë e ardhura është siguruar nga një burim jashtë Shqipërisë, ka menduar fillimisht se detyrimet tatimore nuk ishin detyrimi i tij si përfitues i të ardhurës dhe është mjaftuar vetëm me deklarimin e të ardhurave pranë autoritetit tatimor sepse ligji shqiptar parashikon *mbajtjen e tatimit vetëm mbi të ardhurat të realizuara nga një burim në Shqipëri duke mos u kufizuar vetëm në to* dhe subjekti kishte paqartësi ligjore në lidhje me të ardhurat e krijuara jashtë Shqipërisë. Në fund viti 2016 - fillim viti 2017, pasi ka lexuar rregulloren e shoqërisë ku ishte fituar shuma dhe ka mësuar se pagimi i detyrimeve tatimore për çdo të ardhur të realizuar prej kësaj kompanie ishte detyrim i secilit pjesëmarrës dhe rregullohej sipas legjislacionit kombëtar, si dhe pasi është konsultuar me disa specialistë të fushës, subjekti ka bërë pagesat e detyrimeve tatimore në muajin janar të vitit 2017, duke përdorur si burim të ardhurat e krijuara nga loja e fatit dhe që i kishte ruajtur *cash*.
- Në lidhje me konstatimin e Komisionit, për *...mosdeklarimin e destinacionit të shumës së tërhequr për të gjithë periudhën deri në plotësimin e deklaratës Vetting*, subjekti shpjegon se ka menduar që deklarimi i shumës së fituar në DIPP-në e vitit 2014 dhe në DIVA e vitit 2014 ishte i mjaftueshëm dhe kishte zbatuar parashikimet ligjore. Për sa i përket mospasqyrit të gjendjes *cash* si destinacion i shumës së fituar, ky mosdeklarim nuk ka pasur si qëllim fshehjen e destinacionit, pasi referuar të gjitha deklaratave vjetore të pasurisë që prej vitit 2003, nuk janë deklaruar pakësimi ose shtimet e gjendjes *cash*, por vetëm shtesa kursimesh për shkak të moskuptimit të drejtë/ose kuptimit të gabuar të parashikimit ligjor.

Gjatë një intervistimi në ILDKPKI, në vitin 2017 pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, është sqaruar se kishte detyrimin për deklarimin e gjendjes *cash*.

- Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale, datë 14.7.2022, të bashkëshortes, e cila deklaron se shuma 75.000 euro është tërhequr nga subjekti në vitin 2014 nga “Raiffeisen Bank” dhe është mbajtur *cash* në banesë e paprekur me qëllim për ta përdorur për ndonjë investim të ardhshëm. Në vitin dhjetor të vitit 2016 i dhanë vjehrrit të saj shumën 58.000 euro që të përfundonte ndërtimin e objektit në pronësi të tij në Sarandë dhe kjo shumë iu kthye në vitin 2020 me transfertë bankare në “Raiffeisen Bank” në llogarinë e subjektit. Gjithashtu, për pagimin e detyrimit tatimor mbi të ardhurat nga lojërat e fatit janë përdorur këto të ardhura që i dispononin në gjendje *cash*.
- Në lidhje me konstatimin e Komisionit, se *deklarimi i subjektit për huan e dhënë babait të tij në shumën prej 58.000 euro duket i dyshimtë dhe nuk është në harmoni/përputhshmëri me deklaratimet e tij, ndër vite, apo në lidhje logjike e ekonomike me investimin e kryer/pretenduar nga babai*, subjekti ka shpjeguar se shumën ia ka dhënë *cash* babait të tij meqë e dispononte, me qëllim përfundimin e punimeve të objektit në Sarandë dhe kryerjen e pagesave për regjistrimin e tij në regjistrat publikë, siç edhe provohet nga deklaratat noteriale e lëshuar prej babait të tij. Burimi i krijimit të shumës së dhënë hua babait është nga lojërat e fatit *online*. Kjo shumë është kthyer në datën 14.12.2020 me transfertë bankare. Babai dhe vëllezërit i kanë bërë me dije se për të përfunduar objektin nevojiteshin rreth 100.000 - 120.000 euro dhe për diferencën do të merrnin hua te të afërm, por meqë nuk arritën të gjenin hua pranuan ofertën për ta shitur objektin. Mosdeklarimi i shumës së dhënë hua në DIPP-në e vitit 2016 ka qenë harresë nga subjekti dhe është deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2017. Subjekti, në lidhje me këto fakte, shpjegon se i provon me të dhënat e llogarisë së tij në “Raiffeisen Bank”, datë 14.12.2020, me deklaratën noteriale të babait L. S., datë 26.1.2017, si dhe me deklaratën noteriale, datë 14.7.2022, të bashkëshortes E. S..
- Në lidhje me konstatimin e Komisionit, se *vlera prej 75.854 euro e tërhequr nga gjendja e llogarisë bankare dhe e pretenduar se është mbajtur në shtëpi nga subjekti, nuk vjen në harmoni me situatat e deklaruara nga subjekti në DIPP-të 2014–2016, ku rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë marrë kredi bankare për nevoja familjare, si dhe kredi për të shlyer një kredi tjetër*, subjekti ka shpjeguar se siç ka deklaruar në pyetësorë kreditë kanë qenë konsumatore dhe janë përdorur për shpenzime familjare në vijimësi, pasi nga muaji janar i vitit 2014 e në vijim, bashkëshortja është larguar nga puna dhe familja kishte vetëm një person të punësuar. Shpenzimet nuk janë mbuluar me të ardhurat e fituara sepse subjekti dhe bashkëshortja kanë vlerësuar që shuma e disponuar prej tyre *cash* (e fituar në lojë fati) të ruhej e paprekur me qëllim kryerjen e ndonjë investimi të mëvonshëm. Pavarësisht, se konkludohet se nuk vijnë në harmoni veprimet e kryera (marrje kredie), ata i kanë vlerësuar asokohe, si të vlefshme për ekonominë familjare.
- Për dy konstatimet më lart, subjekti ka bashkëlidhur si provë të re deklaratën noteriale, datë 14.7.2022, të bashkëshortes E. S.

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Komisioni, në lidhje me shpjegimet e subjektit për konstatimin se *duket e dyshimtë transferta e shumës prej 75.860 euro në llogarinë e subjektit, për sa kohë nuk provohet dërgimi i saj nga llogaria e lojtarit si dhe nisur nga tërheqja e saj menjëherë*”, vëren se subjekti ka shpjeguar sesi kjo shumë e fituar ka kaluar nga llogaria e lojtarit te llogaria e kompanisë \*\*\* për të kaluar më pas në llogarinë e tij rrjedhëse në monedhën euro, “Raiffeisen Bank”, pavarësisht se pagesat ishin bërë nga llogaria e tij e kartës së kreditit. Veprimet e transfertës janë kryer duke lënë gjurmë, prandaj referuar edhe dokumentacionit provues që ka depozituar subjekti, Komisioni vlerëson se shpjegimet e tij janë bindëse në lidhje me faktin që transferta e shumës 75.860 euro është bërë nga

Ilogaria e subjektit si lojtar pranë kompanisë \*\*\* te Ilogaria bankare e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”.

- Në lidhje me konstatimin e Komisionit, se *tërheqja e shumës 75.860 euro është kryer menjëherë...*, shpjegimet e subjektit se nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor në lidhje me mënyrën e disponimit të kësaj shume në bankë ose jashtë saj dhe as detyrim ligjor për vlerën *cash* që duhet të mbahet jashtë sistemit bankar në këndvështrim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, për sa kohë që subjekti është deklarues që prej vitit 2004 dhe jo deklarues për herë të parë, Komisioni vlerëson se nuk janë të bindëse sepse nuk kanë bazë ligjore, si vijon:
- Neni 4, pika 1/d, e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, përcakton qartë detyrimin e subjekteve deklarues për të deklaruar, pavarësisht nga vlera, *vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari ...*. Ky detyrim është përcaktuar edhe në përmbajtjen e formularit të deklarimit periodik të pasurive, të cilit çdo subjekt deklarues duhet t’i përmbahet gjatë plotësimit të këtij formulari. Neni 4/1 i këtij ligji, të cilit i referohet subjekti në prapësimet e tij, përcakton: “*Të gjithë zyrtarët, të cilët për shkak të funksionit publik që kryejnë, bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarimin për herë të parë sipas nenit 5/1, të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Për zyrtarët që deklarojnë, sipas nenit 5/1, të këtij ligji, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve cash mbi vlerën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI*”. Pra, neni 4/1 përcakton një limit ligjor të vlerës së gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar që duhet deklaruar domosdoshmërisht nga subjektet që deklarojnë për herë të parë, si dhe detyrimin që këta subjekte duhet të depozitojnë shumat mbi këtë vlerë në sistemin bankar, ndryshe nga subjektet e tjerë që duhet të deklarojnë gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar pavarësisht nga vlera *cash*.
- Detyrimet e përcaktuara në nenin 4, pika 1/d dhe në nenin 4/1 janë qartësisht të ndryshme dhe nuk mund ngatërrohen me njëra-tjetrën. Për këto arsye, me mosdeklarimin e gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar, subjekti nuk ka përmbushur një detyrim ligjor.
- Gjithashtu, Komisioni sqaron se veprimin e tërheqjes menjëherë të shumës së fituar në lojërat e fati e ka parë në harmoni me mosdeklarimin e kësaj shume si gjendje *cash* ndër vite dhe me veprimet e tjera të subjektit për të arritur në konkluzionin se këto veprime në tërësinë e tyre krijojnë dyshimin që subjekti nuk e ka disponuar në vazhdimësi, realisht, shumën e fituar, pasi e ka tërhequr nga Ilogaria e tij bankare.
- Në lidhje me konkluzionin e Komisionit, për *moshlyerjen e detyrimeve tatimore në kohën e përfitimit (pagimi i tyre duket se është bërë për efekt të deklaratës Vetting dhe duket se shuma 1.250.000 lekë e paguar si tatim mbi të ardhurat nga lojërat e fatit nuk mund të ketë si burim krijimi këto të ardhura)*, shpjegimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi me plotësimin e DIVA 2014, ku është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit e ardhura *bruto* e fituar në lojëra fati, automatikisht është llogaritur nga sistemi, detyrimi tatimor për pagesën e tatimit në burim, detyrim mbi të cilin, më pas, janë llogaritur edhe kamatëvonesat dhe interesat. Pavarësisht nga kjo, subjekti sërish nuk e pa paguar detyrimin tatimor në momentin e llogaritjes nga sistemi me justifikimin se nuk e kishte kuptuar ligjin, por Komisioni vëren se nisur nga fakti që subjekti e kuptoi ligjin pas 3 vjetësh dhe fillon pagimin e detyrimit tatimor, pikërisht në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, prapësimet e subjektit për këtë pikë të konkluzionit nuk janë bindëse, pasi nuk bazohen as në fakt e as në ligj, duke u krijuar kështu bindja se kjo pagesë është bërë për efekt të procesit *Vetting*.

- Në lidhje me konstatimin e *mosdeklarimit të destinacionit të shumës*, Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi nëse kjo shumë është mbajtur *cash* prej tij në banesë, sikurse ka pretenduar, atëherë në përputhje me detyrimin ligjor që buron nga neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe nga ligji nr. 84/2016, subjekti duhej të deklaronte gjendjen *cash* të shumës së fituar nga loja e fatit, në çdo DIPP qysh nga viti 2014 e në vijim për sa kohë e dispononte atë.

- Në lidhje me konstatimet e Komisionit se *deklarimi i subjektit për huan e dhënë babait të tij në shumën prej 58.000 euro duket i dyshimtë dhe nuk është në harmoni/përputhshmëri me deklaramet e tij ndër vite, apo në lidhje logjike e ekonomike me investimin e kryer/pretenduar nga babai i tij*, si dhe *vlera prej 75.854 euro e tërhequr nga gjendja e llogarisë bankare dhe e pretenduar se është mbajtur në shtëpi nga subjekti, nuk vjen në harmoni me situatat e deklaruara nga subjekti në DIPP-të 2014 – 2016, ku rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë marrë kredi bankare për nevoja familjare, si dhe kredi për të shlyer një kredi tjetër*, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime, si edhe gjatë hetimit, kështu që prapësimet e paraqitura nuk janë bindëse dhe të mjaftueshme për Komisionin.

Për sa më lart, Komisioni konkludon se subjekti provoi që ka fituar shumën 75.860 euro nga lojëra fati dhe transfertat e saj nuk është e dyshimtë, por tërheqja e menjëhershme e saj, mosdeklarimi i saj në DIPP-të vjetore si gjendje *cash*, pagesa e detyrimeve tatimore mbi këtë shumë jo në kohën kur e fitoi dhe e deklaroi këtë shumë, por për efekt të procesit *Vetting*, fakti që shumën 75.854 euro e pretenduar se është mbajtur *cash* në banesë nuk vjen në harmoni me situatat e deklaruara nga subjekti në DIPP 2014 – 2016, kur subjekti dhe bashkëshortja kanë marrë kredi bankare për nevoja familjare, si dhe kredi për të shlyer një kredi tjetër (trajtuar më poshtë); fakti që nuk e ka deklaruar huan që i ka dhënë babait në DIPP-në e vitit përkatës 2016, nuk krijojnë bindjen që kjo shumë ka ekzistuar që pas tërheqjes e në vijim dhe që është përdorur si burim për huan që subjekti i ka dhënë babait.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni për huan prej 58.000 euro (që subjekti i rivlerësimi i ka dhënë babait L. S.)**

**4.1** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) deklaratë noteriale<sup>15</sup>, datë 26.1.2017, ku shtetasi L. S. deklaroi se i ka marrë hua djalit të tij Alfred Sali, në dhjetor të vitit 2016 shumën 58.000 euro për vazhdimin e punimeve të filluara që nga viti 2007 e në vazhdim për ndërtimin e një banese 4+1 kat, në lagjen nr. \*\*\*, mbi ish-hotel \*\*\*, në Sarandë. Kjo shumë ka shërbyer për një pjesë të pagesave të personave që kryejnë ndërtimin: (ii) leje ndërtimi me subjekt ndërtues “\*\*\*\*” sh.p.k. e miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.10.2006, të KRRT-së për ndërtim banese, e cila financohet nga shtetasi L. S..

**4.2** ASHK-ja konfirmon<sup>16</sup> se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë vetëdeklarues për efekt legalizimi të ndonjë objekti informal, por shtetasi L. S. ka aplikuar (regjistër deklaratë SR – nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2017, Sarandë) dhe është pajisur me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 25.10.2017, për godinë banimi 5 kate, Bashkia Sarandë.

**4.3** Komisioni ka administruar<sup>17</sup> dosjen e legalizimit dhe praktikën e tij<sup>18</sup>.

<sup>15</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 26.1.2017, e shtetasit L. S.

<sup>16</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2020, e ASHK-së.

<sup>17</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2022, e ASHK-së Sarandë.

<sup>18</sup>Dokumentacioni i depozituar: (i) kërkesë për legalizim nr. SR – \*\*\* prot., datë 31.5.2017, nënshkruar nga L. S. që ka deklaruar se godina është ndërtuar në vitin 2006; (ii) certifikatë familjare, datë 21.5.2017, ku figurojnë prindërit, motra dhe një vëlla i subjektit; (iii) leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 25.10.2017, për pasurinë nr. \*\*\*, me sip. totale 708 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi 128 m<sup>2</sup>, 5 kate,

**4.4** Në lidhje me investimin e kryer në këtë ndërtesë 4+1 kat, në pyetësin nr. 2 subjekti ka shpjeguar se punimet e objektit janë kryer prej babait dhe vëllezërve të tij, në mënyrë private. Objekti është financuar tërësisht me të ardhurat e siguruara nga emigrimi i tyre në Greqi për periudhën 1998 – 2011. Të ardhurat e realizuara (vetëm ato të evidentuara në regjistrat publikë) për periudhën deri në fund të vitit 2010, periudha kur kanë vijuar investimet në objekt, kapin një shumë 183.392 euro. Në vitin 2011 familjarët e subjektit janë kthyer nga emigrimi, por për shkaqe financiare, objekti nuk përfundoi tërësisht. Meqë punimet nuk përfunduan tërësisht brenda afatit të lejes së ndërtimit, babai i subjektit aplikoi në datën 31.5.2017, për legalizimin e objektit dhe u pajis me leje legalizimi, datë 25.10.2017, që e regjistroi në datën 31.01.2018 dhe u pajis me certifikatë pronësie për pasurinë nr. \*\*\*, në emër të L. S. Këtë objekt, sipas kontratës për shitje me rezervë<sup>19</sup>, datë 14.8.2020, si dhe deklaratës noteriale<sup>20</sup>, datë 26.10.2020, prindërit e subjektit ia kanë shitur blerësve B. L. dhe M. S., në vlerën 225.000 euro.

**4.5** Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar aktet e përmendura në përgjigje dhe dokumente mbi të ardhurat nga emigrimi në Greqi<sup>21</sup>, pagesën e shumës 20.000 euro në datën 21.2.2020 nga blerësi M. S. në favor të shitësit L. S., si dhe deklaratën noteriale datë 26.10.2020, ku palët deklarojnë se është likuiduar tërësisht çmimi 225.000 euro

**4.6** Referuar deklaratës noteriale, datë 26.1.2017, ku shtetasi L. S. deklaroi se i ka marrë hua djalit Alfred Sali, në dhjetor të vitit 2016 shumën 58.000 euro, Komisioni vëren se subjekti nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 këtë hua të dhënë *cash* me marrëveshje verbale. Në pyetësin nr. 2<sup>22</sup>, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i huas në DIPP-në e vitit 2016 ka qenë harresë prej tij, gjë që konfirmohet nga fakti që deklarimin e ka bërë në DIPP-në e vitit 2017 shoqëruar me deklaratën noteriale, ku pasqyrohet se shuma prej 58.000 euro i është dhënë hua babait në dhjetor të vitit 2016. Huan ia ka dhënë *cash* babait, pasi disponohej prej subjektit dhe për shkak të raporteve të posaçme familjare dhe të marrëdhënieve të besimit mes palëve.

**4.7** Sipas përshkrimit të llogarisë së subjektit nga “Raiffeisen Bank”, huaja është kthyer nga z. L. S. në datën 14.12.2020, duke e kaluar në llogarinë e subjektit nr. \*\*\*-euro, në “Raiffeisen Bank”<sup>23</sup>.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit që duket se:

---

në emër të L. S. S.; (iv) shkresë e ASHK-së Sarandë, datë 4.3.2020, që konfirmon se L. S. ka shlyer detyrimin financiar për parcelën ndërtimore në shumën 385.000 lekë; etj.

<sup>19</sup>Kontratë shitje me rezervë me nr. \*\*\*, datë 14.08.2020.

<sup>20</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 26.10.2020.

<sup>21</sup>Dokumentacioni i depozituar: (i) A. S., të ardhura vjetore rreth 12.000 euro/vit, disponohen vetëm bilancet e tatimit mbi të ardhurat personale të personave fizikë, sipas deklaratës fillestare me kod fiskal nr. \*\*\*, Athinë, për vitet 2002 – 2008, kurse për periudhën 1998 – 2002 nuk disponojnë dokumentacion; (ii) A. S., të ardhura vjetore rreth 12.000 euro/vit, disponohen vetëm bilancet e tatimit mbi të ardhurat personale të personave fizikë, sipas deklaratës fillestare me kod fiskal nr. \*\*\*, Athinë, për vitet 2001 – 2010, kurse për periudhën 1998 – 2001 nuk disponojnë dokumentacion; (iii) prindërit në vitet 1998-2010 dhe motra I. S. në vitet 2003 – 2010, ndonëse pagesat mujore kanë qenë në vlefën prej 800 euro - 1200 euro në muaj/ për person = 9600-14.400 euro në vit/ për person, nuk disponohet dokumentacion, për shkak të punës së pasiguar në mënyrë të plotë, në sigurimet shoqërore të shtetit grek; (iv) transfertën e pagesës së çmimit të shitjes së objektit në BKT, në favor të L. S.; (v) preventiv për kryerjen e punimeve që kishin mbetur pa u kryer nga shitësit, vlefë prej 14.296.480,80 lekë i përpiluar me porosi të blerësve pas shitjes së objektit, ku pasqyrohet vlera e punimeve; (vi) foto të jashtme të objektit në vitin 2017 në kohën që objekti është pajisur me leje legalizimi; (vii) raport vlerësimi, datë 24.9.2020, i kryer nga “ABI Bank”, Tiranë, në funksion të aplikimit për kredi nga blerësit B. L., sipas të cilit objekti i përfunduar në masën 71/% është vlerësuar në vlerën 226.000 euro.

<sup>22</sup>Pyetja nr. 1 në pyetësin nr. 2.

<sup>23</sup>Shihni përshkrim llogarie të subjektit nga “Raiffeisen Bank”, datë 2.11.2021.

- Subjekti nuk e ka disponuar shumën e pretenduar deri në datën e dhënies së huas, pasi nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 huan në shumën 58.000 euro që i ka dhënë babait në vitin 2016, nuk ka deklaruar gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2014, apo pakësimin e saj në DIPP-në e vitit 2016.
- Deklarimi i subjektit për huadhënien në deklaratën *Vetting* është deklarim i rremë, nisur nga faktet që shumën prej 75.854 euro e ka tërhequr nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”, menjëherë pas transferimit të fondeve dhe nuk ka deklaruar destinacionin e tyre, si dhe dhënia e huas nuk gjen pasqyrim në deklaratimet periodike të subjektit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**4.8** Në prapësimet e tij për barrën e provës, subjekti ka shpjeguar se për disponueshmërinë e gjendjes *cash*, provat e administruara në fazën e hetimit administrativ vërtetojnë se shuma është fituar prej tij është tërhequr nga banka dhe i është dhënë babait në vitin 2016. Kjo shumë nuk është shpenzuar prej tij, pasi nga hetimi nuk rezultoi asnjë veprim juridik në drejtim të blerjes/ investimit të ndonjë pasurie të paluajtshme apo transfertë bankare në atë vlerë ose vlerë të përafërt. Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve deklaratën noteriale, datë 14.5.2022, të bashkëshortes E. S., ku konfirmohet se shuma e fituar në lojëra fati *online* është mbajtur *cash* prej tyre.

**4.9** Në lidhje me konstatimin e Komisionit se duket që deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* për huadhënien është deklarim i rremë, subjekti ka shpjeguar se shuma i është dhënë *cash* babait, pasi disponohej *cash* prej tij, si dhe për shkak të raporteve të posaçme familjare dhe të marrëdhënieve të besimit mes tyre. Arsyet për të cilat është dhënë huaja dhe kthimi i saj janë shpjeguar nga subjekti në prapësimet e tij.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**4.10** Në lidhje me prapësimet e mësipërme, Komisioni merr në konsideratë në tërësinë e tyre shpjegimet e subjektit gjatë hetimit dhe në prapësime se huan prej 58.000 euro ia ka dhënë *cash* babait me marrëveshje verbale bazuar në marrëdhënien e posaçme familjare dhe të besimit midis tyre, por Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit për disponimin e gjendjes *cash* të shumës 58.000 euro së dhënë hua, janë në nivel deklarativ pavarësisht fakteve të tilla si fitimi i të ardhurave nga lojërat e fatit *online*, në llogarinë e tij bankare në vitin 2014, tërheqja e kësaj shume nga banka dhe mungesa e ndonjë investimi/blerje pasurie nga subjekti deri në vitin 2016.

**4.11** Nga ana tjetër, subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 huan në shumën 58.000 euro që i ka dhënë babait në vitin 2016, nuk ka deklaruar destinacionin e shumës 75.860 euro të fituar në lojëra fati *online*, as gjendje *cash* të saj në DIPP-në e vitit 2014 apo pakësimin e saj në DIPP-në e vitit 2016. Pra, shpjegimet e subjektit nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse, prandaj, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting* në lidhje me huan dhe nuk e ka disponuar shumën e pretenduar deri në datën e dhënies së huas babait të tij.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni, në lidhje me likuiditete *cash* në vlerën 9.000 euro (pjesa takuese 100%)**

**5.1** Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike, Komisioni kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash*, ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016, në raport me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të bërë në deklaratën *Vetting*.

**5.2** Nga deklaratimet periodike, referuar shtesave dhe pakësime, ndër vite, të gjendjes *cash*, nga përlllogaritjet rezultoi se gjendja *cash* në monedhën lekë në datën 31.12.2016 është në shumën



1.050.000 lekë dhe ka si burim pagat, në deklaratën *Vetting* (datë 29.1.2017) subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën 9.000 euro me burim nga lojëra fati *online*, ndërsa në pyetësin nr. 3 ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.150.000 lekë dhe 17.000 euro.

**5.3** Duket se ka mospërputhje të gjendjes *cash* dhe burimit të deklaruar në deklaratimet periodike dhe në pyetësorë, me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*, paraqitur në vijim në formë tabelare.

**Tabela nr. 1**

DIPP	Deklarimi i gjendjes <i>cash</i> në DIPP-të	Gjendja <i>cash</i> , datë 31 dhjetor të çdo viti në lekë, sipas DIPP-ve	Gjendja <i>cash</i> , në datën 31 dhjetor të çdo viti në lekë, sipas pyetësorit nr. 3
2003		0	
2004		0	
2005	<i>Gjendje cash viti 2006. Vlera 150,000 lekë</i>	150,000	150,000
2006		150,000	150,000
2007		150,000	150,000
2008		150,000	150,000
2009	<i>Kursime nga të ardhurat prej pagës 400,000 lekë</i>	550,000	950,000
2010	<i>Kursime nga paga 200,000 lekë</i>	750,000	1,150,000
2011	<i>Kursime nga paga 300,000 lekë</i>	1,050,000	1,450,000
2012		1,050,000	1,450,000
2013		1,050,000	1,150,000
2014		1,050,000	1,150,000 lekë dhe 75,000 euro
2015		1,050,000	1,150,000 lekë dhe 75,000 euro
2016		1,050,000	1,150,000 lekë dhe 17,000 euro

**5.4** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, që duket se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë lidhur me gjendjen *cash* dhe burimin e tyre nga lojërat e fatit *online*.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**5.5** Në prapësime subjekti ka shpjeguar se në DIPP që prej vitit 2003 nuk ka deklaruar pakësime ose shtime të gjendjes *cash* për shkak të moskuptimit të drejtë/ose kuptimit të gabuar të parashikimeve ligjore. Kjo vërtetohet me faktin se në të gjitha DIPP-të e deklaruara janë pasqyruar vetëm “shtesa kursimesh” të ardhur nga paga. Me detyrimin se duhej të kishte deklaruar gjendjen *cash* është bërë me dije dhe sqaruar gjatë një intervistimi në ILDKPKI.

**5.6** Në vijim, subjekti sqaron se në analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash*, ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016, Komisioni ka përllogaritur të gjitha shumat që subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike, duke deduktuar se gjendja *cash* në datën 31.12.2016 është në shumën 1.050.000 lekë dhe ka si burim “pagat” (çka i referohet deklaratimeve periodike në kohë), ndërkohë që subjekti pretendon se nuk ka deklaruar gjendjen *cash* dhe, rrjedhimisht, as pakësimin e saj, ndër vite, ose burimin e tyre, as në DIPP-në e vitit 2016 dhe as në DIPP-të e mëparshme. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti e ka marrë si të mirëqenë këtë përllogaritje të bërë nga Komisioni, duke u deklaruar për shkak pakujdesie, gabimisht si e tillë. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar për herë të parë, gjendje *cash* në shumën 9.000 euro me burim nga “lojëra fati *online*”, sepse deri në fillim të muajit dhjetor të vitit 2016 ndodhej si gjendje *cash* në banesë shuma 75.000 euro, me burim

krijimi “lojëra fati *online*” dhe shuma 2.000 euro me burim “kursimet ndër vite” (e konvertuar prej monedhës lekë). Nga kjo shumë i ka dhënë shumën 58.000 euro babait në muajin dhjetor dhe ka paguar tatimin mbi të ardhurat në vlerën 1.250.000 lekë, në janar të vitit 2017. Pra, në atë kohë, diferenca e mbetur *cash* ishte në shumën prej 77.000 euro - 58.000 euro - 10.000 euro = 9.000 euro. Në total në banesë, në datën 29.01.2017 kishte gjendje *cash* shumën 9.000 euro, sikurse ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

**5.7** Në vijim, subjekti shpjegon se në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka deklaruar gjendjen *cash* në fund të vitit 2016 shumat 1.150.000 lekë dhe 17.000 euro, pasi gabimisht i është referuar gjendjes *cash* të përlllogaritur nga Komisioni, e cila në fakt nuk është e saktë sepse nuk ka deklaruar as shtim as pakësim të gjendjes *cash* ndër vite. Rezulton se gjendja *cash* në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 19.000 euro dhe pasi ka paguar edhe tatimin për të ardhurat nga lojërat e fatit në muajin janar të vitit 2017, në kohën e deklarimit të deklaratës *Vetting* ka patur si gjendje *cash* në banesë shumën prej 9.000 euro me burimi krijimi “lojëra fati *online*”, siç ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

**5.8** Pra, sa më sipër, subjekti pretendon se deklaratimet e tij në deklaratën *Vetting* janë të sakta, qoftë për sa i përket huas që i ka dhënë babait, ashtu edhe për gjendjen *cash* në banesë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**5.9** Në lidhje me shpjegimet e tij në prapësime për deklarimin e gjendjes *cash*, ndër vite, Komisioni vëren se në pjesën më të madhe të DIPP-ve subjekti nuk ka deklarim për gjendjen *cash*. Në vitet kur ka një deklarim të tillë, subjekti ka deklaruar vetëm kursime nga pagat, pa specifikuar nëse kemi të bëjmë me “shtesë” apo me “gjendje”, me përjashtim të deklarimit të parë të gjendjes *cash* në DIPP-në e vitit 2006, ku subjekti ka specifikuar se shuma e deklaruar prej 150.000 lekësh është gjendje *cash* në vitin 2006. Në deklaratimet e radhës për gjendjen *cash*, konkretisht në DIPP-të për vitet 2009-2011, subjekti nuk ka përdorur as termin “gjendje” dhe as termat “ndryshim/pakësim/shtesë”, por ka deklaruar “kursime nga paga në lekë”.

**5.10** Për sa më lart, subjekti nuk provoi dot të kundërtën e barrës së provës për rezultatin se duket që ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me gjendjet *cash* dhe burimin e tyre nga lojërat e fatit *online*.

Në përfundim, lidhur me pasuritë (4 dhe 5) të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe të trajtuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit që duket se:

- Mosdeklarimi në asnjë deklaratë i destinacionit të shumës 75.854 euro të përfituar nga lojërat e fatit *online*, si dhe i gjendjes *cash* të kësaj shume në DIPP-të, ndër vite, pasi i ka tërhequr ato nga llogaria e tij bankare.
- Marrja e një kredie bankare në “Raiffeisen Bank”, në datën 11.4.2016, në shumën 1.200.000 lekë, kur ndërkohë pretendon se ka pasur një gjendje të konsiderueshme *cash* në banesë, të paktën prej 58.000 euro + 9.000 euro.
- Ekzistenca e një tjetër kredie që në vitin 2013 e në vazhdim edhe pas fitimit të lotarisë, konkretisht, kredi personale në shumën 728.000 lekë në “Raiffeisen Bank”, e cila nuk është shlyer me shumën e fituar në lotari, por është paguar në vazhdimësi deri në vitin 2016, kur është shlyer me një kredi tjetër.

**5.11** Të gjitha rrethanat e trajtuara më lart dhe konstatimet e Komisionit ngrenë dyshimin e arsyeshëm mbi ekzistencën reale të shumës 75.854 euro së fituar në lojëra fati *online*, pas momentit të tërheqjes fizike nga banka, apo edhe mbi përfitimin real të saj prej subjektit të rivlerësimit dhe,

për rrjedhojë, duket se subjekti ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *Vetting* lidhur me dhënien e huas në shumën 58.000 euro babait të tij dhe gjendjes *cash* të shumës 9.000 euro.

**5.12** Subjekti rivlerësimit ka rezultuar se ka pasur lëvizje bankare në vijueshmëri për periudhën 2012-2016 të vlerave monetare, me destinacion lojërat e fatit, të cilat nuk vijnë në përputhje me figurën dhe integritetin e një prokurori dhe, po ashtu, ulin shkallën e besueshmërisë së publikut te drejtësia.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**5.13** Në prapësime subjekti ka shpjeguar se lidhur me pasaktësitë në deklarime për sa i përket deklarimeve të tij në DIPP-të, ndër vite, i është referuar jurisprudencës së dy vendimeve të fundit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: në vendimin nr. 37, datë 24.11.2021 (në faqen 10, pika 10.12), citohet se: *“Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi<sup>24</sup>. Në të kundërt, pasaktësitë e pretenduara në deklarimet periodike nuk mund të shërojnë dhe as të shpjegojnë mungesën e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare që bëhet mbështetur mbi këto deklarime, e cila mbetet dhe konsiderohet si shkak shkarkimi, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”*; në vendimin nr. 33, datë 3.11.2021 (në faqet 13-14, pika 26), citohet se: *“... trupi gjykues vlerëson se duhet të sjellë në vëmendje jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, në lidhje me vlerën e provës së deklarimeve të mëparshme të interesave pranë ILDKPKI-së. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 u ka njohur vlerën e provës deklarimeve të mëparshme të interesave privatë, për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit në raport me deklarimin e tij në deklaratën e rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, Komisioni megjithëse ka arsyetuar mbi vlerën e provës së deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, analizën e tij në lidhje me burimet e krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit e ka mbështetur vetëm në këtë deklaratë. Komisioni nuk e ka nisur kontrollin nga deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit dhe më tej të bënte ballafaqimin e krahasimin e këtij deklarimi me atë të para fillimit të detyrës në vitin 2006, por është përqendruar vetëm në kontrollin e deklarimeve të Faqja 14 nga 51 subjektit në këtë të fundit. Fillea e kontrollit nga deklarata e pasurisë së rivlerësimit merr rëndësi në përcaktimin e përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në kontekst dhe për qëllim të këtij procesi. Në konkluzionet e tij, Komisioni është i paqartë në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016”*.

**5.14** Po kështu, në pikën 27 të të njëjtit vendim argumentohet se: *“... sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, neni 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, të cilët kanë përcaktuar qartësisht se procesi i rivlerësimit fillon nga deklarimet e subjektit të rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit për secilin prej kritereve, në rastin konkret në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, në analizën e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit, duhet të kishte filluar procesin e rivlerësimit me verifikimin dhe kontrollin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e më tej të krahasonte e analizonte atë në raport me deklarimet periodike të interesave në kuptim të provës në këtë proces. Konkluzionet e arritura nga Komisioni duhet t'i referoheshin përgjegjësisë*

*disiplinore të subjektit të rivlerësimit lidhur me deklaratën e tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e për më tepër të ishin të qarta në lidhje me shkeljet konkrete sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016”.*

**5.15** Pra, në përfundim, provohet se të ardhurat janë deklaruar prej meje në mënyrë të saktë dhe të plotë, ashtu sikurse dhe burimi i krijimit të tyre, deklarim i cili është bërë pranë organeve tatimore edhe në DIPP-në e vitit 2014, si dhe janë paguar detyrimet tatimore.

**5.16** Në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: *“Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.* Të ardhurat përbëjnë të ardhura të ligjshme, pasi neni 4 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon..... gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiteoza, si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit”.* Për këto të ardhura, referuar shkresave nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2012, të DRT-së Vlorë dhe nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2022, subjekti shpjegon se është regjistruar pranë kësaj drejtorie në datën 28.4.2015 dhe në datë 30.4.2015 ka deklaruar të ardhura bruto nga lojëra fati, shumën 11.063,850 lekë (sipas kursit të këmbimit euro/lekë të kohës që i korrespondon vlefës prej 79.027.50 euro), si dhe ka paguar për këtë shumë tatimin prej 1.250.000 lekësh.

**5.17** Në lidhje me konstatimin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se ka pasur lëvizje bankare në vijueshmëri për periudhën 2012–2016 të vlerave monetare, me destinacion lojërat e fatit, të cilat nuk vijnë në përputhje me figurën dhe integritetin e një prokurori dhe, po ashtu, ulin shkallën e besueshmërisë së publikut të drejtësia*, prapësimet e subjektit janë pasqyruar në vijim të vendimit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**5.18** Në lidhje me prapësimet e subjektit, Komisioni sqaron se pavarësisht praktikës së Kolegjit që referon subjekti, mënyra e deklarimit të tij është e njëjtë qoftë për huan që i ka dhënë babait, qoftë për gjendjen *cash* në vlerën 9.000 euro, duke i deklaruar ato vetëm në deklaratën *Vetting* dhe në asnjë deklaratë vjetore qysh nga momenti i krijimit. Gjithashtu, disponimin *cash* të shumës që ka futur nga lojërat e fatit *online* nuk e ka deklaruar as në deklaratat vjetore as në deklaratën *Vetting*. Pra, nuk jemi para rastit kur subjekti ka bërë edhe deklarime në DIPP vjetore edhe deklarime në deklaratën *Vetting* dhe nën dritën e praktikës së Kolegjit, Komisioni duhet të bënte analizë duke u nisur nga deklarata *Vetting* dhe, më pas, krahasimin e saj me DIPP-të vjetore. Fakti që subjekti nuk ka bërë deklarime në DIPP-të vjetore nuk mundëson për të kuptuar se çfarë ka ndodhur me të ardhurat e tij (shumën e fituar në lojëra fati). Në këtë rast, nuk arrihet të provohet që këto të ardhura janë disponuar prej tij dhe janë përdorur si burim për huan e dhënë babait dhe për gjendjen *cash* në shumën 9.000 euro.

**5.19** Mosdeklarimi në asnjë deklaratë (*Vetting* apo DIPP) i destinacionit të shumës 75.854 euro të përfituar nga lojërat e fatit *online*, mosdeklarimi në asnjë DIPP vjetore i gjendjes *cash* të kësaj shume, pasi subjekti e ka tërhequr nga llogaria e tij bankare, mosdeklarimi në vitin përkatës 2016 i huas në shumën 58.000 euro dhënë babait, përveç si mospërmbushje e detyrimeve ligjore nga ana e subjektit janë parë nga Komisioni si rrethana, të cilat së bashku me faktin e ekzistencës së dy kredive që nga viti 2013 të cilat nuk u shlyen me të ardhurat nga lojërat e fatit, e bëjnë të pamjaftueshëm e të pasaktë deklarimin për huan 58.000 euro dhe për gjendjen *cash* 9.000 euro në deklaratën *Vetting*.

**5.20** Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se DIPP-ja e vitit 2016 është dorëzuar në ILDKPKI në datën 31.3.2017, pas deklaratës *Vetting*, e cila është dorëzuar në datën 29.1.2017 dhe,

çuditërisht, subjekti ka pasqyruar në deklaratën *Vetting* huan e dhënë babait prej 58.000 euro dhe gjendjen *cash* prej 9,000 euro, por nga ana tjetër nuk i ka pasqyruar këto pasuri në DIPP-në e vitit 2016, megjithëse kjo e fundit është dorëzuar në ILDKPKI pas deklaratës *Vetting*, duke krijuar kështu bindjen e Komisionit se shuma prej 75.000 euro nuk ka ekzistuar si gjendje *cash* e mbartur ndër vite, po ashtu, edhe huadhënia babait të tij prej 58,000 euro nuk është reale.

**5.21** Gjithashtu, Komisioni mban në konsideratë edhe praktikën e Kolegjit<sup>25</sup> që arsyetojnë dhe konkludojnë në mospresumimin nga ana e Komisionit të përdorimit nga subjektet të gjendjeve *cash*, si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë që një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike. Komisioni e mban në konsideratë këtë qëndrim të Kolegjit në raport me tërësinë e provave dhe deklarimeve të subjektit, si dhe në vlerësim të parimit të proporcionalitetit, ku subjekti nuk e ka deklaruar gjendjen *cash* prej 75.000 euro dhe as shtesa apo pakësime të saj, për disa vite, konkretisht, në DIPP-të për vitet 2014, 2015 dhe 2016 dhe nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 pakësimin e gjendjes *cash* me 58.000 euro nga huadhënia babait të tij për 58.000 euro, si dhe gjendjen *cash* të mbetur në fund të vitit 2016.

**5.22** Për sa më lart, Komisioni, pasi i vlerëson të pamjaftueshme e të pabazuara në ligj prapësimet e subjektit, arrin në përfundimin se:

- mosdeklarimi në asnjë deklaratë i destinacionit të shumës 75.854 euro të përfituar nga lojërat e fatit *online*, si dhe i gjendjes *cash* të kësaj shume në DIPP-të ndër vite, pasi subjekti i tërhoqi menjëherë ato nga llogaria e tij bankare;
- marrja e kredisë bankare në shumën 1.200.000 lekë në “Raiffeisen Bank”, në datën 11.4.2016, kur ndërkohë subjekti pretendon se ka pasur një gjendje të konsiderueshme *cash* në banesë, të paktën prej 58.000 euro + 9.000 euro;
- ekzistenca e një kredie personale në shumën 728.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, që nga viti 2013 e deri pas fitimit të lotarisë, e cila nuk është shlyer me shumën e fituar në lojëra fati, por është shlyer në vazhdimësi deri në vitin 2016 me një kredi tjetër;
- mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2016 i huas në shumën 58.000 euro që subjekti i dha babait;
- mospagimi në kohë i detyrimit tatimor për shumën 75.854 euro, si e ardhur e përfituar nga lojërat e fatit *online*;
- deklarimi i pasaktë në lidhje me gjendjen *cash* në shumën 9.000 euro në deklaratën *Vetting*.
- dorëzimi i DIPP-së të vitit 2016 në ILDKPKI pas asaj të deklaratës *Vetting* dhe mos pasqyrimi në të i gjendjes *cash* dhe i huas dhënë babait të tij,

krijoi bindjen mbi mosekzistencën reale të shumës 75.854 euro së fituar në lojëra fati pas momentit të tërheqjes fizike nga banka prej subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting* lidhur me dhënien e huas prej 58.000 euro babait të tij dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për dhënien e huas në shumën 58,000 euro dhe për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 9.000 euro.

**6. Hua për hapje aktiviteti tregtar shtetases I. S. (e motra) me afat 5 vjet (shihni deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., datë 26.1.2017). Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga, si dhe mbyllja e depozitës së kursimit pranë “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes E. S..**

**6.1** Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Dhënie huaje për hapje aktiviteti tregtar shtetases I. S. (e motra e subjektit) më afati 5 vjet. Shuma 1.000.000 lekë. Kontratë verbale*”.

<sup>25</sup>Vendimet e Kolegjit: (a) (JR), nr. 7/2019, nr. 11/2019, nr. 20/2019, etj.

**6.2** Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar: “*Depozitë me afat në Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortes, data e hapjes së depozitës më 26.7.2012, data e maturimit të depozitës më 26.7.2013, nga kursimet, shtesa interesi bruto në shumën 56.612 lekë, zotëron 50%*”.

**6.3** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*: (i) deklaratë noteriale<sup>26</sup>, datë 26.1.2017, sipas së cilës shtetasja I. S. deklaroi se ka marrë hua shumën 1.000.000 lekë në muajin tetor të vitit 2014 nga vëllai i saj Alfred Sali, për nevojat e aktivitetit tregtar mini market, i regjistruar në datën 1.11.2013, si person fizik me NIPT \*\*\*. Shuma e marrë hua është pa interes dhe kthimi pa afat; (ii) ekstrakti i QKB-së, datë 26.1.2017, i personit fizik I. S. me status aktiv, i regjistruar në datën 1.11.2013, me NIPT \*\*\*, me aktivitet “Mini market”, me adresë në Sarandë; (iii) kontratë depozite me afat e lidhur në datën 26.7.2012 midis “Raiffeisen bank” dhe shtetases E. S. me nr. Klienti \*\*\*, për investimin në depozitë të shumës 1.272.200 lekë, me afat 12-mujor, nga data 26.7.2012 - 26.7.2013, me interes 4.45 %.

**6.4** Komisioni, në pyetësin nr. 3, i ka kërkuar subjektit: (i) të japë shpjegime në lidhje me mospërputhjen e kohës së dhënies së huas, pasi në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar dhënien e huas në vitin 2013 për afatin 5 vjet, kurse I. S. në deklaratën noteriale, datë 26.1.2017, ka deklaruar se ka e marrë huan në shumën 1.000.000 lekë në tetor të vitit 2014 pa afat; (ii) të shpjegojë dhe provojë mënyrën e dhënies së huas (*cash* apo me transfertë bankare), si dhe nëse është kthyer ose jo kjo hua.

**6.5** Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se huaja është dhënë *cash*, për shkak të raporteve familjare me një afat 5-vjeçar në vitin 2013, nga të ardhurat nga paga, si dhe mbyllja e depozitës së kursimit në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes E. S.. Deklarimi i motrës në deklaratën noteriale është lapsus për shkakun se marrëdhënia financiare ka qenë verbale dhe huaja është dhënë në vitin 2013, jo në tetor të vitit 2014.

#### **Analiza e burimit të krijimit të shumës 1.000.000 lekë dhënë hua personit tjetër të lidhur/ I. S.**

**6.6** Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar hua në shumën 1.000.000 lekë dhënë motrës së tij me qëllim për hapjen e aktivitetit tregtar të saj. Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për huan e dhënë.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi si burim krijimi për huan mbylljen e depozitës së bashkëshortes në “Raiffeisen Bank” dhe të ardhurat nga paga.

**6.7** Në lidhje me depozitën e bashkëshortes, Komisioni administroi dokumentacionin bankar. “Raiffeisen Bank”<sup>27</sup> konfirmon depozitën bankare në vlerën 1,272,200 lekë, në emër të bashkëshortes së subjektit, e cila është hapur në datën 26.7.2012 dhe është maturuar në datën 26.7.2013, në vlerën 1.323.151 lekë. Më pas, kjo depozitë është tërhequr me tri veprime bankare: 500.000 lekë, në datë 31.7.2013; 300.000 lekë, në datë 2.8.2013; si dhe 500.000 lekë, në datë 9.9.2013.

Depozita rezultoi se ka si burim depozitën me nr. \*\*\* lekë krijuar në datë, 7.6.2011, në vlerën 1.212.082 dhe maturuar në datën 7.6.2012, në vlerën 1.272.244 (deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2011 nga subjekti dhe bashkëshortja, ndërsa në DIPP-në e vitit 2012 subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar: “*Depozitë me afat në Raiffeisen Bank (depozitues). Data e çeljes 7.6.2011. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: pagat*”.

<sup>26</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 26.1.2017.

<sup>27</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020.

Në vijim, nga veprimet bankare konstatohet se shuma 1.212.082 lekë është krijuar nga vlerat e kredituara në llogarinë e bashkëshortes së subjektit nga llogaritë e tjera të saj në “Raiffeisen bank” (shuma 80.000 lekë është transferuar nga llogaria e pagës, ndërsa shuma 862.000 lekë është transferuar nga një tjetër llogari depozite) dhe depozitimi *cash* i saj në vlerën 270.000 lekë. Nga analiza financiare, duket se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi të krijojnë depozitën në vitin 2012, pasi rezultojnë me një balancë pozitive.

Gjithashtu, duket se shumatat e tërhequra nga llogaria e depozitës janë të mjaftueshme për të mbuluar dhënien e huas në datën 31.10.2013.

**6.8** Në lidhje me të ardhurat nga pagat, Komisioni administroi dokumentacionin e depozituar nga subjekti për marrëdhënien e punësimit dhe i mori në konsideratë ato në analizën që kreu për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për dhënien e huas, duke iu referuar burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionit ligjor të disponuar, sipas tabelës vijuese.

**Tabela nr. 2**

<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2013 - 31.10.2013</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>1,295,865</b>
Të ardhura nga paga e subjektit (sipas “Raiffeisen Bank”)	833,880
Të ardhura nga paga e bashkëshortes (sipas “Credins Bank”)	461,985
<b>Detyrime</b>	<b>-1,000,000</b>
Dhënë hua motrës në shumën 1.000.000 lekë, tetor 2013	(1,000,000)
<b>Shpenzime</b>	<b>947,606</b>
Shpenzime jetike	470,080
Shpenzime udhëtimi	0
Shpenzime qiraje	200,000
Shpenzime mobilimi	29,762
Pagesë kredie	50,613
Shpenzime për lojëra fati	181,572
Shpenzime interesi MC	15,579
<b>Pasuri</b>	<b>-1,237,113</b>
Ndryshim likuiditeti	-1,237,113
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>585,372</b>

**6.9** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, që duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 pakësimin e depozitës së bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”, depozitë e cila deklarohet që është përdorur si burim krijimi për dhënien e huas në shumën 1.000.000 lekë, shtetases I. S.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**6.10** Në prapësime subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja ka qenë subjekt i deklarimit të ligjit dhe ky detyrim për pasqyrimin në DIPP-në viti 2013 mbi pakësimin e llogarisë është detyrim i saj, pasi depozita ka qenë në emër të bashkëshortes. Mosdeklarimi lidhet me harresën, çka argumentohet me faktet se: së pari, bëhet fjalë për veprime në një llogari bankare, e cila është deklaruar prej bashkëshortes në të gjitha DIPP-të në mënyrë periodike së bashku me ndryshimet përkatëse përgjatë viteve; së dyti, pakësimi i llogarisë rezulton si i tillë në llogarinë e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”; së treti, në këtë llogari nuk janë deklaruar më ndryshime në DIPP-të pasardhëse (DIPP-të pas largimit nga funksioni), çka vërteton faktin se ka qenë harresë.

**6.11** Në vijim, subjekti sqaron se lidhur me pasaktësitë në këtë deklaram, i referohet si më lart jurisprudencës së Kolegjit, me vendimet nr. 37, datë 24.11.2021 dhe nr. 33, datë 3.11.2021.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**6.12** Referuar analizës së bërë gjatë hetimit, subjekti dhe bashkëshortja kanë rezultuar me të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës që ka shërbyer si burim për dhënien e huas. Gjithashtu, depozita e bashkëshortes së subjektit dhe ndryshimet e saj janë deklaruar periodikisht.

**6.13** Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i mbylljes së depozitës së bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank”, e cila deklarohet se është përdorur si burim krijimi për dhënien e huas në shumën 1.000.000 lekë, shtetases I. S., nuk e bën të pavërtetë deklaramin *Vetting* të subjektit se *burim krijimi i huas që i ka dhënë motrës I. S. janë të ardhura nga paga, si dhe mbyllja e depozitës së bashkëshortes* dhe, për këtë arsye, edhe shpjegimet e subjektit Komisioni i vlerëson të mjaftueshme dhe bindëse.

**Për sa më lart, Komisioni vlerëson se në lidhje me huan e dhënë shtetases I. S. nuk paraqiten problematika që e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi disiplinore për këtë deklaratë.**

### **DETYRIME FINANCIARE**

#### **7. Kredi bankare në “Raiffeisen Bank”. Shuma 1.200.000 lekë, kontratë datë 11.4.2016.**

Qëllimi: për arsye personale, si dhe shlyerjen e një kredie të mëparshme ndaj “Raiffeisen Bank” (kredi bankare, datë 7.11.2013, principali 728.000 lekë). Mbetur pa shlyer në datën 31.12.2016, shuma 1.108.989,58 lekë.

**7.1** “Raiffeisen Bank”<sup>28</sup> konfirmon disbursimin e kredisë në shumën 1.200.000 lekë, në datën 11.4.2016, në llogarinë e subjektit. Nga veprimet bankare rezulton se me marrjen e kredisë, subjekti ka paguar 559.109.04 lekë për detyrimin e mbetur të kredisë 728.000 lekë që ka marrë në datën 7.11.2013. Pjesën e mbetur të kredisë së disbursuar prej 620.800 lekësh, subjekti e ka tërhequr *cash* në të njëjtën datë. Këtë shumë Komisioni e ka konsideruar si shpenzim për vitin 2016.

**Nuk konstatohet problematikë për huan në shumën 1.200.000 lekë, marrë nga subjekti në vitin 2016.**

#### **8. Kartë krediti në euro, datë 31.11.2011, shuma 800 euro, në “Raiffeisen Bank”. Në datën 27.1.2017, gjendja është në shumën 415.23 euro. Gjendje detyrimi në shumën 385.77 euro.**

**8.1** Subjekti e ka deklaruar kartën e kreditit në DIPP-në e vitit 2012 e në vazhdim.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: vërtetim<sup>29</sup> nga “Raiffeisen Bank” që konfirmon se subjekti ka kartë krediti të hapur në datën 31.11.2011, në shumën 800 euro, me balanca të disponueshme në shumën 415 euro në datën 27.1.2017.

**8.2** Nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” konfirmohet gjendja e deklaruar nga subjekti dhe nga veprimet bankare rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur kartën e kreditit për të kryer pagesa për \*\*\* (kompani bastesh), konkretisht: shumën 1.575 euro në vitin 2012; shumën 1.405 euro për vitin 2013; shumën 1.758 euro për vitin 2014; 554 euro për vitin 2015 dhe 809 euro për vitin 2016. Këto pagesa janë pasqyruar si shpenzime në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

<sup>28</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020.

<sup>29</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”.



**8.3** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, që duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, kartën e kreditit në vlerën 800 euro.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**8.4** Subjekti ka shpjeguar se në lidhje me këtë moment ka qenë harresë nga ana e tij gjatë përpilimit të deklaratës, duke referuar si element justifikues jurisprudencën e Kolegjit, me vendimet nr. 37, datë 24.11.2021 dhe nr. 33, datë 3.11.2021.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**8.5** Komisioni i vlerëson të mjaftueshme shpjegimet e subjektit, duke e konsideruar mosdeklarimin e kartës së kreditit në vlerën 800 euro, në DIPP-në e vitit 2011 si një veprim të paqëllimshëm dhe që nuk përbën shkak për ngarkimin e subjektit me përgjegjësi.

**Për sa më lart, në lidhje me kartën e kreditit në “Raiffeisen Bank”, datë 31.11.2011, shuma 800 euro, Komisioni nuk konstatoi problematika.**

#### **❖ Konstatime të tjera për subjektin e rivlerësimit**

**9. Në DIPP, ndër vite, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto adresa banimi:** (i) lagjja “\*\*\*\*”, Gjirokastër; (ii) rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Sarandë; (iii) pallati nr. \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, Sarandë; (iv) pallati nr. \*\*\*, kati \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, Sarandë; (v) pallati nr. \*\*\*, kati \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, Sarandë (e prindërve); (vi) rruga “\*\*\*\*”, pallati. \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, Sarandë; (vii) pallati nr. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, Vlorë.

**9.1** Në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se adresa e tij e banimit që nga momenti i fillimit të detyrës e deri më sot është në Lagjen Nr. \*\*\* Sarandë, banesë e prindërve për efekt të regjistrimit në Gjendjen Civile të qytetit të lindjes, ndërsa adresa e qëndrimit, e cila mund të jetë pasqyruar gabimisht prej tij si adresë banimi (ose për shkak të mungesës së zërit përkatës në rubrikë) ka ndryshuar në varësi të vendndodhjes së punës. Në periudhën nëntor 2004 – dhjetor 2011 ai dhe familja e tij kanë jetuar në Gjirokastër, në një apartament me qira 1+1, pallati nr. \*\*\*, kati \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Rruga e \*\*\*, qiradhënës M. (M.) K. D., me pagesë 10.000 lekë, marrëveshje verbale e përvitshme. Duke qenë se shtetasi banonte si emigrant në shtetin grek, kjo pagesë qiraje është kryer *cash* çdo muaj te shtetasi J. D., i afërm i tij dhe për 2 vitet e fundit është kryer në “Raiffeisen Bank”, sipas marrëveshjes verbale në llogarinë e shtetasit S. G. B., kunat i qiradhënësit (bashkëlidhur kopje e ekstraktit bankar të znj. E. S., shihni veprimin datë 6.10.2011 pagesë qiraje, datë 28.12.2010 pagesë CEZ/NUK Gjirokastër, etj.)

**9.2** Referuar këtij ekstrakti dhe lëvizjeve të llogarive bankare të bashkëshortes së tij, rezulton se pagesa e datës 28.12.2010 është në vlerën 3.582 lekë, në favor të CEZ për llogari të shtetasit M. D., kurse në favor të Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër është vlera 1.118 lekë. Pagesa e datës 6.10.2011 është me vlerë 10.000 lekë në favor të shtetasit S. B. “pagesë qiraje tetor 2011”. Nuk rezultojnë pagesa të tjera qiraje të kryera me bankë.

**9.3** Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetasve M. (M.) K. D., J. D. dhe S. G. B., por nuk rezultoi<sup>30</sup> një situatë e tillë.

---

<sup>30</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**9.4** Edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 4 subjekti ka shpjeguar se për efekt të regjistrimit në Zyrën e Gjendjes Civile Sarandë, që nga momenti i fillimit të detyrës e deri më sot, ka deklaruar si adresë banimi adresën e banesës në pronësi të prindërve të tij, pallat i cili aktualisht mban numrin \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, rruga \*\*\*\*, Sarandë. Ky pallat, sipas numërtimit të kryer para dhe pas viteve 1990, mbante nr. \*\*\*, rruga nr. \*\*\*, siç rezulton edhe në kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 6.7.1993. Në vijim, i njëjti pallat ka ndryshuar numërtimin disa herë (po kështu edhe emri i rrugëve) gjatë implementimit të sistemit të adresave në qytet dhe aktualisht ka nr. \*\*\*.

**9.5** Komisioni vëren se në DIPP-në e viteve 2011 – 2016 subjekti ka deklaruar si adresë banimi lagjen \*\*\*\* Vlorë, por në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka deklaruar se në periudhën janar 2012 – dhjetor 2013 ka banuar në apartament me qira në lagjen \*\*\*\*, Vlorë, te kulla \*\*\*\*, kati \*\*\*, kurse nga janari 2014 e në vijim ka banuar në apartament me qira në lagjen \*\*\*\*, Vlorë, kulla \*\*\*, hyrja nr. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, në pronësi të shoqërisë \*\*\*\* sh.p.k., me qira mujore 20.000 lekë sipas një marrëveshjeje verbale.

**9.6** Komisioni vëren se në DIPP-të e viteve 2011 – 2013 subjekti nuk ka deklaruar marrëdhënien e qirasë për apartamentin në kullën \*\*\*\*, Vlorë dhe në DIPP-të e viteve 2014 dhe 2015 nuk ka deklaruar marrëdhënien e qirasë për apartamentin me sip. 110.8 m<sup>2</sup> me shoqërinë \*\*\*\* sh.p.k.

**9.7** Komisioni vëren se në DIPP-të e viteve 2004 – 2015, subjekti nuk ka deklaruar banesë të tij me qira. Për këtë, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka shpjeguar se ai dhe familja e tij kanë jetuar me qira përgjatë viteve dhe nuk kanë pasur banesë në pronësi. Nuk ka deklaruar banesë në qira për pakujdesi në plotësimin e deklaratës, pra neglizhencë në pasqyrimin e të drejtës së përdorimit të banesave. Nuk ka deklaruar as shpenzimet e qirasë për banesat me qira, pasi parashikimet ligjore dhe formati i deklarimit të interesave private kërkonin deklarimin e shpenzimeve mbi 500.000 lekë/vit. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar printimin nga sistemi i ASHK-së që nuk konfirmon pasuri të paluajtshme në pronësi të subjektit.

**9.8** ASHK-ja konfirmon<sup>31</sup> se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të nuk figurojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme.

**9.9** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit që duket se subjekt i rivlerësimit:

- Nuk ka deklaruar dhe as provuar marrëdhëniet e qirasë për banesat e përdorura, pavarësisht se nga DIPP-të e viteve 2004 – 2015 ka deklaruar adresa banimi.
- Nuk provon pagesat e qirasë për 2 vitet e fundit (nëntor 2009 – dhjetor 2011) në “Raiffeisen Bank” në llogarinë e shtetasit S. G. B., të kryera sipas marrëveshjes verbale me qiradhënësin M. (M.) K. D.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**9.10** Në prapësime, në lidhje me konstatimin e parë të Komisionit, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pyetësorët gjatë hetimit.

**9.11** Në lidhje me konstatimin e dytë të Komisionit, subjekti ka depozituar vërtetimin e datës 14.7.2022, të “Raiffeisen Bank” duke shpjeguar se pagesat janë kryer prej tij dhe bashkëshortes së tij në llogarinë e shtetasit S. B. me nr. \*\*\*, në periudhën 2010 – 2012, sikurse ka deklaruar edhe në përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm, por këtë vërtetim bankar nuk e ka paraqitur më parë,

<sup>31</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, të ASHK-së.

sepse pagesat janë kryer me mandat pranë arkës së bankës dhe jo me transfertë bankare nga llogaria e tij ose e bashkëshortes.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**9.12** Në lidhje me konstatimin e parë të Komisionit, meqë subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pyetësorë gjatë hetimit, Komisioni nuk i konsideron të mjaftueshme shpjegimet e tij.

**9.13** Në lidhje me konstatimin e dytë të Komisionit se për periudhën nëntor 2009 – dhjetor 2011, subjekti nuk provon pagesat e qirasë të kryera në “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e shtetasit S. G. B., Komisioni vëren se referuar vërtetimit datë 14.7.2022, të “Raiffeisen Bank”, të depozituar nga subjekti gjatë prapësimeve, pagesat mujore në vlerën 10.000 lekë janë bërë për harkun kohor maj 2010 – nëntor 2011. Pra, nuk provohen pagesat për periudhën nëntor 2009 – prill 2010.

**9.14** Për sa më lart arrihet në përfundimin se subjekti nuk ka deklaruar dhe provuar me dokumentacion ndër vite marrëdhëniet e qirasë, për sa kohë që subjekti ka deklaruar adresa banimi dhe nuk është provuar që të ketë një banesë në pronësi të tij. Nga ana tjetër, subjekti ka provuar pagesat e qirasë për 18 muaj, duke provuar kështu ekzistencën e një marrëdhënieje qiraje vetëm për këtë periudhë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk deklaruar dhe provuar marrëdhëniet e qirasë për banesat e përdorura, pavarësisht se në DIPP-të e viteve 2004 – 2015 i ka deklaruar si adresa banimi, me përjashtim të marrëdhënies së qirasë sipas marrëveshjes verbale me qiradhënësin M. (M.) K. D., për të cilën provon pagesën e qirasë mujore vetëm për periudhën maj 2010 – nëntor 2011, por në një vlerësim tërësor kjo situatë vlerësohet si një pasaktësi në deklarim, e cila, e parë e veçuar nga problematikat e tjera, nuk konsiderohet me aq peshë saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**10. Të drejta që burojnë prej vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 24.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me objekt “zgjidhje kontrate pune”, me palë të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Tiranë. Detyrimin e këtij organi për shpërblimin e paditësit E. S. (H.) me 12.5 paga mujore në shumën 72.820 lekë paga mujore. Vendim i paekzekutuar në shumën 910.250 lekë.**

**10.1** Ky deklarim është bërë për herë të parë në DIPP-në e vitit 2016 dhe më pas në DIPP-në e vitit 2017.

**10.2** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: vendimin nr. \*\*\*, datë 24.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me të cilin gjykata ka vendosur në datën 24.2.2016 që paditësi E. S. të përfitojë nga i padituri DPT Tiranë dhe DRT Vlorë dëmshpërblimin e 12.5 pagave mujore, pagë e cila është në shumën *bruto* 72.820 lekë/muaj.

**10.3** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar arkëtimin e shumës 910.000 lekë si shpërblim nga vendimi gjyqësor dhe ka depozituar nxjerrje llogarie të bashkëshortes së tij E. S., në datën 11.3.2021, nga “Raiffeisen Bank”, ku rezulton se kjo shumë është depozituar në llogarinë e saj në datën 24.11.2017.

### **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar.**

#### **Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

**10.4** Bazuar në analizën e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 2003 – 2016 të kryer nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi

subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit që duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë në shumën totale prej 8.707.775 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit**

**10.5** Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se në lidhje me këtë moment kërkon nga Komisioni të marrë në konsideratë të ardhurat e deklaruara si gjendje *cash* në vlerën 75.000 euro, të cilat kanë pasur burim krijimi të ardhurat nga lojërat e fatit. Në vijim, subjekti shpjegon se referuar edhe përgjigjeve të tij për konstatimet e Komisionit mbi pasuritë 4 dhe 5, provohet se e ardhura është fituar prej tij, transferta është reale, e ardhura ka pasur burim të ligjshëm, si dhe janë paguar detyrimet tatimore.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni vëren se referuar konkluzioneve që ka arritur më lart, në lidhje me pasuritë e subjektit të rivlerësimit Alfred Sali, pasi ka marrë në shqyrtim edhe prapësimet e tij, të cilat vlerëson se nuk qëndrojnë për sa trajtuar më lart, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë në shumën totale prej 8.707.775 lekësh.

Periudha	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	
<b>PASURI</b>	0	0	400,000	150,909	-46	3,335	16,507	151,173	641,529	1,031,994	394,077	-1,203,392	112,993	4,031	8,422	
Automjet i markës 'Mercedes Banz' me targë ***											400,000					
Apartament banimi 78 m2, Sarandë , p.takuese 20%																
Automjet tip Benz Mercedes vp.2010,p.takuese 100% 11.9.2004			400,000				-400,000									
<b>DIFERENCE LIKUIDITETI (LIK. AKTUAL - LIKUIDITETE VITI PARAAAR</b>	0	0	0	150,909	-46	3,335	16,507	551,173	641,529	1,031,994	-5,923	-1,203,392	112,993	4,031	8,422	
LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	0	0	0	0	150,909	150,863	154,198	170,704	721,877	1,363,406	2,395,400	2,389,477	1,186,085	1,299,078	1,303,109	
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	0	0	0	150,909	150,863	154,198	170,704	721,877	1,363,406	2,395,400	2,389,477	1,186,085	1,299,078	1,303,109	1,311,531	
<b>DETYRIME</b>	0	0	0	0	0	0	369,556	-60,173	-71,827	-86,023	-103,038	-384,807	-22,446	-641,241	-6,726,608	
Hua 58,000 euro dhënë L.S															-7,845,660	
Hua 1,000,000 lekë dhënë L.S												-1,000,000	0			
Kredi bankare 1,200,000 lekë në RBAL 11.4.2016															1,119,052	
Kredi bankare 728,000 lekë në RBAL 7.11.2013												663,688	-77,346	-586,341		
Kredi bankare personale 400,000 lekë RBAL 22.5.2008							369,556	-60,173	-71,827	-86,023	-103,038	-48,495		54,900	-54,900	
Kredi bankare personale 54,900 lekë te Union Bank														54,900	-54,900	
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	0	0	400,000	150,909	-46	3,335	-353,049	211,346	713,356	1,118,017	497,115	-818,585	135,440	-645,273	6,735,030	
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	0	259,047	939,442	881,813	1,006,435	1,059,944	1,273,003	1,724,688	1,680,130	1,859,148	1,970,096	1,666,724	12,105,907	1,388,982	1,159,776	
Të ardhura nga paga e subjektit prokuroria Gjirokastrë 1.10.2003-30.11.2011		259,047	939,442	881,813	893,919	935,756	1,018,369	1,303,362	1,269,857	1,279,857	0	0	0	0	0	
Të ardhura nga paga e subjektit prokuroria Vlorë 1.12.2011-janar 2017										0	1,259,917	1,039,022	1,385,448	1,388,982	1,159,776	
Të ardhura nga paga e b/shortes Drejtoria e Spitalit Gj. nëntor 2004- Maj 2007				112,516	0	0										
Të ardhura nga paga e b/shortes Qendra Shëndetësore Gj. Maj 2007 - Janar 2009					124,188	254,634	102,377	0	0							
Të ardhura nga paga e b/shortes Drejtoria e Spitalit Gj. Janar 2009 - Tetor 2010							318,949	250,924	0	0	0	0	0	0	0	
Të ardhura nga paga e b/shortes DRTatimore Gj.tetor 2010- shkurt 2012								151,987	579,291	92,228	0	0	0	0	0	
Të ardhura nga paga e b/shortes DRTatimore Vlorë, shkurt 2012- janar 2014										557,789	243,079	91,714	0	0	0	
Të ardhura nga leja e lindjes DRSSH Vlorë , 2013											333,671					
Të ardhura nga lojrat e fatit													10,628,745			
Të ardhura nga interesat e depozitave RBAL								7,362		60,162	50,952					
<b>SHPENZIME</b>	0	59,180	149,578	357,176	514,626	863,618	1,030,867	1,174,598	863,090	744,557	1,186,094	1,787,341	12,364,048	1,400,626	2,098,213	
Shpenzime jetike	23,466	93,864	109,557	250,630	707,904	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	564,096	879,992	897,104	940,368		
Shpenzime udhëtimi			91,905	108,281	0	24,636	547,308	247,064	142,449	41,916	0	84,066	41,295	0	0	
Shpenzime qiraje		20,000	120,000	120,000	120,000	120,000	120,000	120,000	120,000	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000	
Shpenzime mobilimi	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	35,714	
Blerje laptop														54,900		
Shpenzime interesi kredie						40,657	61,716	50,452	36,534	18,886	2,119	116,797	89,960	133,361		
Shpenzime i kredisë						400,000					728,000			620,891		
Shpenzime për lojra fati										220,059	196,995	246,313	76,258	109,433		
Shpenzime interesi MC										1,246	20,417	19,461	20,295	18,445		
Shpenzime për bileta avioni													58,899			
Shumë e shpenzuar 75,854 euro													10,627,904			
Pagese në llogari të shtetasit A.M dt.5.11.2012											205,200					
<b>LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT</b>	0	0	0	150,909	150,863	154,198	170,704	721,877	1,363,406	2,395,400	2,389,477	1,186,085	1,299,078	1,303,109	1,311,531	
Cash			150,000	150,000	150,000	150,000	150,000	550,000	750,000	1,050,000	1,050,000	1,050,000	1,050,000	1,050,000	1,050,000	
Llogari page Credins Bank *** E.S											827	356	1,752	2		
Llogari page BKT E.H				392	4,000	4,000	79,284	17	0							
Llogari page RBAL_ A.S ***			909	471	198	16,704	-7,407	1,609	-2,879	567	-35,448	-63,969	-68,449	-70,000		
Llogari tërheqje MC_ A.S *** EUR											-112,061	-113,337	-113,607	-112,044	-107,613	
Llogari rrjedhëse RBAL_ A.S *** EUR													0			
Llogari tërheqje MC_ E.S ***												-20,716	41	0		
Llogari page RBAL_ E.S ***									-19	64,893	-15	-20	-28	0		
Llogari depozite RBAL_ E.S ***								82	0	60	19	0				
Depozita							100,000	0	1,212,082	1,272,200						
Llogari depozite RBAL_ E.S ***								611,717	5,197	5,258	0					
Llogari depozite RBAL_ J.S ***									66,106	172,641	305,232	424,888	433,600	439,144		
				Gjendje në cash vitit 2006. Vlera 150,000 lekë.				Kursime nga të ardhurat prej pagës 400,000 lekë	Kursime nga paga 200,000 lekë	Kursime nga paga 300,000 lekë						
Deklarim në DIPP																
Analiza dokumentuar	0	199,867	389,864	373,728	491,855	192,991	595,185	338,744	103,684	-3,427	286,887	697,968	-393,581	-656,917	-7,673,467	

## B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision raportin<sup>32</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Alfred Sali, i deklasifikuar plotësisht me vendimin<sup>33</sup> e KDZH-së. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës i DSIK-së, në përfundim të verifikimit ka konkluduar se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës.

b) Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

c) Informacioni i ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme na bën me dije se: “Për shtetasin Alfred Sali është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2013, në ngarkim të tij, dërguar për transferim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, në datën 18.4.2013 nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është vendosur pushimi i procedimit penal nr. \*\*\*, i vitit 2013, për veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.

Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjykatësve, duke filluar nga subjekti, gjykojmë se ky rast nuk është në objektin e ligjit nr. 84/2016 dhe, si i tillë, nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton *përshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Alfred S. Sali.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk u konstatuan problematika që mund të çojnë konsiderimin si të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë KLP-së, si organi ndihmës për vlerësimin etiko-profesional, ka hartuar dhe ka përcjellë në Komision raportin<sup>34</sup> mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Alfred Sali.

Ky raport, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet<sup>35</sup>, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit<sup>36</sup>:

<sup>32</sup>Raporti nr. \*\*\*, datë 2.11.2017, i DSIK-së.

<sup>33</sup>Vendim nr. \*\*\*, datë 21.1.2022, i KDZH-së.

<sup>34</sup>Raporti nr. \*\*\*prot., datë 15.2.2022, i KLP-së, miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.2.2022, të KLP-së, depozituar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2022.

<sup>35</sup>Formulari i vetëdeklarimit të subjektit dhe dokumentet bashkëlidhur; tri aktet e përzgjedhura nga subjekti; 5 aktet e përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv nga përfaqësues të KLP-së dhe Komisionit, etj.

<sup>36</sup>a) Aftësitë profesionale ku përfshihen:

*Njohuritë ligjore* – subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore (të sjella nga subjekti) dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet e zbatimit të saj në rastin konkret. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2012 – 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, ai është vlerësuar *shumë mirë*.

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

2. Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, Komisioni vëren se bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, në DIPP-të vjetore dhe në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, duket që subjekti për vite me radhë që nga viti 2012 e në vijim ka investuar në lojëra fati ku dhe ka përfituar shuma monetare. Përfshirja në këto lojëra, mbart rrezikun e varësisë ndaj tyre dhe, si rrjedhojë, edhe cenimin e imazhit të subjektit përballë publikut. Sjellja e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka qenë e rregulluar me ligjin nr. 8737/2001 dhe më pas me ligjin nr. 96/2016 i ndryshuar. Edhe në Kodin e Etikës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë të miratuar në datën 19.6.2014 janë përcaktuar rregulla të sjelljes në jetën private të tyre.

3. Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit që duket se në dritën e dispozitave dhe akteve ligjore si më lart, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë integritetin, figurën e subjektit, si dhe shkallën e besueshmërisë së publikut te drejtësia.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

4. Në prapësime, subjekti ka referuar disa ligje dhe akte nënligjore si: ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë” neni 10 “Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, neni 101/1, germa “a”; ligji nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32, duke shpjeguar se këto akte kanë parashikuar në mënyrë të përgjithshme respektimin e rregullave të etikës, nderit dhe dinjitetit, të cilat

---

*Arsyetimi ligjor* – nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti shfaq aftësi në arsyetimin ligjor; bën analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore; mbështet arsyetimin ligjor jo vetëm në normat penale, por edhe në ligje të tjera specifike.

b) Aftësitë organizative ku përfshihen:

*Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – nga shqyrtimi i dokumenteve të përzgjedhura me short rezultojnë se subjekti tregon aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës dhe vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore brenda afateve ligjore.

*Aftësia për të kryer procedurat hetimore/ gjyqësore* – subjekti i rivlerësimit, gjatë përfaqësimit të akuzës në gjykim, tregon profesionalizëm dhe në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

*Aftësia për të administruar dosjet* – subjekti ka treguar aftësi të mira në drejtim të rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, me akte të vendosura në mënyrë kronologjike, të njohin më faktin penal, me qëndrimin e subjektit dhe disponimin e gjykatës.

c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale ku përfshihen:

*Etika në punë* – nga aktet e përzgjedhura nga subjekti dhe nga dosjet e zgjedhura në short rezultojnë se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

*Integriteti, paanësia* – nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm; nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit; nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar; asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave; nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, ku përfshihen:

(a) *aftësitë e komunikimit*; (b) *aftësia për të bashkëpunuar*; (c) *gatishmëria për t'u angazhuar*. Subjekti shfaq aftësi të mira komunikimi dhe sjellje të mirë, ka aftësi bashkëpunimi dhe pune në grup, si dhe është i angazhuar në një sërë aktivitetesh profesionale.

diskreditojnë figurën e magjistratit ose dëmtojnë besimin e publikut te drejtësia. Këto dispozita ligjore përfaqësojnë, në fakt, dispozita blankete, pasi nuk parashikojnë konkretisht se cilat janë rregullat etike që duhen/duheshin zbatuar apo sjelljet, të cilat përbëjnë cenim të figurës së magjistratit. Nga kjo pikëpamje rregullimi i vetëm për prokurorët është bërë me urdhrin nr. \*\*\*, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi miratimin e Rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”.

5. Në vijim, subjekti shpjegon se në urdhrin nr. \*\*\*, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, neni 10 “Integriteti dhe korrektësia” nuk ka asnjë parashikim në lidhje me konstatimin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë integritetin, figurën e subjektit, si dhe shkallën e besueshmërisë së publikut te drejtësia*, sepse në pikën 4 të këtij neni parashikohet se prokurorët nuk duhet të frekuentojnë ambiente ose lokale, të cilat do të dëmtojnë imazhin e tyre si prokuror, veprime që nuk janë kryer kurrë prej subjektit, pasi sikurse rezulton e provuar tashmë, veprimet e tij janë kryer vetëm në ambiente private të banesës. Veprimet e tij janë kondicionuar nga përjetimi moral, pas aksidentit me pasojë vdekje në vitin 2013 kur u përfshi, si dhe nga situata familjare pas largimit të bashkëshortes padrejtësisht nga puna në vitin 2014 (provuar me vendim gjyqësor). Pavarësisht nga këto shkaqe, ato janë veprime që nuk duhet të kryheshin prej tij. Gjithashtu, nga informacionet e administruara nga agjencitë ligjzbatuese nuk ka rezultuar asnjë e dhënë në drejtim të përfshirjes së subjektit në veprimtari ose sjellje që do të cenonin figurën e magjistratit.

6. Në lidhje me shkallën e besueshmërisë së publikut, subjekti ka përmendur emërimin e tij ndër vite si drejtues seksionesh në organin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në pozicionin e zv/drejtues të kësaj prokurorie në datën 9.2.2021, si dhe disa procedime penale që kanë pasur impakt publik dhe ku ndjekja penale është ushtruar prej tij duke pretenduar se këto janë prova të matshme që nuk është ulur shkalla e besueshmërisë së publikut te drejtësia.

### **Vlerësimi i Komisionit**

7. Në lidhje me prapësimet e subjektit, Komisioni vëren se subjekti i referohet urdhrin nr. \*\*\*, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave mbi sjelljen dhe etikën e prokurorëve”, neni 10 “Integriteti dhe korrektësia”, pika 4 që parashikon se prokurorët nuk duhet të frekuentojnë ambiente ose lokale, të cilat do të dëmtojnë imazhin e tyre si prokuror, ndërkohë që subjekti pretendon se veprimet e tij janë kryer vetëm në ambiente private të banesës.

8. Pavarësisht nga citimi dhe kuptimi literal që subjekti i bën kësaj dispozite, qëllimi i saj është të ruajë imazhin e subjekteve në sytë e publikut. Subjekti pretendon se veprimet e tij të pjesëmarrjes në lojëra fati nuk i ka ekspozuar në ambiente publike, por nga ana tjetër nëpërmjet deklaratimit të këtyre veprimeve në deklaratat e të ardhurave dhe në deklaratën *Vetting* pranë institucioneve që kanë akses nga publiku në lidhje me këto deklaratat, e ka bërë të ekspozueshëm figurën e subjektit dhe këtë sjellje të tij përballë publikut.

9. Udhëzimet Europiane mbi Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve Publikë “Udhëzimet e Budapestit”, të cilat gjithashtu përbëjnë një nga bazat ligjore për Rregullat dhe Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve, përcaktojnë një gamë të gjerë rregullash që zbatohen për sjelljen profesionale, si dhe rregullat që zbatohen për sjelljen private të një prokurori. Në kapitullin IV “Sjellja private” të këtyre udhëzimeve, udhëzimi “a” përcakton: *“Prokurorët publikë nuk duhet të kompromentojnë integritetin, drejtësinë dhe paanësinë e perceptuar ose të arsyeshme të shërbimit të prokurorisë publike, me aktivitetet në jetën e tyre private”*.

10. Edhe në rastet kur publiku i gjerë nuk ka mundësi të vërtetojë pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit në lojëra fati janë institucionet e rivlerësimit ato që kanë qasje në dokumente, të cilat



vërtetojnë një zakon afatgjatë dhe të shpeshtë të pjesëmarrjes në lojërat e fatit/bastet *online*. Interesi i publikut për qëllime të verifikimit të këtyre sjelljeve përfaqësohet nga institucionet dhe është detyrimi i tyre për të vepruar në emër të interesit publik. Pra, edhe në këtë këndvështrim, integriteti i arsyeshëm dhe i perceptuar i një subjekti mund të konsiderohet i kompromentuar përballë publikut.

**11.** Sigurisht që është e kuptueshme gjendja psikologjike dhe emocionale që ka përjetuar subjekti për shkak të situatave të rënda sociale-ekonomike, por kjo nuk e justifikon varësinë e tij nga lojërat e fatit në mënyrë të vazhdueshme, çdo muaj, për vite me radhë që nga viti 2012 deri në gusht 2018, duke shpërfillur kështu edhe ligjin nr. 84/2016 dhe atë nr. 96/2016. Luajtja e lojërave të fatit *online* në vazhdimësi, para, gjatë dhe pas miratimit të ligjit nr. 84/2016, përveçse tregon një mosreflektim të subjektit ndaj kësaj situatë dhe këtij fenomeni, ajo rëndon dhe zbeh në masë të konsiderueshme atë perceptim dhe atë besim të publikut se si duhet apo nuk duhet të jetë një magjistrat në ushtrimin e detyrës së tij edhe jashtë saj në jetën e përditshme.

**12.** Në urdhrin nr. \*\*\*, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, neni 8 përcakton: *“Prokurorët të tregojnë sjellje dhe qëndrim korrekt edhe jashtë sferës së tyre profesionale, për të mos shkaktuar dyshim për ndershmërinë e tyre profesionale”*. Në këtë vështrim, një prokuror që luan në mënyrë të vazhdueshme, shpenzon para duke qëndruar në faqet e lojërave të fatit dhe fiton para nga këto lojëra duhet të mbajë parasysh që ngre dyshime te publiku dhe cenon besimin tek ai si përfaqësues i drejtësisë, në lidhje me burimin dhe vlerën e parave që investon dhe që fiton në këto lojëra, si dhe me menaxhimin e kohës produktive të punës dhe detyrave të tij. Referuar faktit që lojërat e fatit janë një aktivitet me peshë financiare të konsiderueshme, vlerësohet se frekuentimi i vazhdueshëm disavjeçar i tyre nga subjekti, si një funksionar publik me të ardhurat që sjell ky pozicion, përbën një sjellje që në këndvështrimin e publikut dhe të një vëzhguesi të arsyeshëm ndikon negativisht në perceptimin e gjithë profesionit. Fitimi i besimit të publikut është i lidhur direkt me sjelljen e prokurorëve në të gjitha rrethanat e ndryshme, duke e ndërvarur nga një sjellje shembullore<sup>37</sup>.

**13.** Jo vetëm Udhëzimet e Budapestit përcaktojnë mosshterimin e rrethanave të ndryshme të sjelljes së prokurorëve, të cilat duhet të ndërvaren nga sjellja shembullore e prokurorit, por edhe neni 17 i urdhrin nr. \*\*\*, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm përcakton mosshterimin e veprimeve që mund të konsiderohen si shkelje etike e sjelljes së prokurorit, konkretisht pika 2 e këtij neni përcakton: *“Në rastet kur veprimet dhe sjelljet e prokurorit vlerësohen se kanë efekte të ngjashme me rregullat edhe nëse ato nuk janë parashikuar shprehimisht, konsiderohen shkelje të rregullave”*.

**14.** Në bazë të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni ka kompetencën ligjore ta vlerësojë këtë fakt dhe ta konsiderojë pjesëmarrjen në lojërat e fatit si një shkelje etike të subjektit të rivlerësimit. Komisioni mund të arrijë në përfundimin se duke zbatuar nenin 17.2 të Rregullores mbi Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve, duke e lidhur këtë sjellje me ndalimet e parashikuara në nenin 8/d, neni 10, paragrafët 3 dhe 4.

**15.** Ndërkohë, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 5, përcakton se: *“Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor ...”*; neni 4 pika 1 dhe pika 2/b përcakton se: *“Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk*

---

<sup>37</sup>Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës, sesioni VI, Udhëzime evropiane mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve – Udhëzimet e Budapestit, CPGE (2005) 05, 31.5.2005, Pika II.

është duke ushtruar funksionet zyrtare” dhe “Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë”.

**16.** Gjithashtu edhe ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” neni 10 përcakton se *prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës dhe në vështrim të kësaj dispozite subjekti duhet të sillet në përputhje edhe me dispozitat më lart të ligjit nr. 96/2016.*

**17.** Pika 1/c e nenit 101, të ligjit nr. 96/2016 përcakton se: “Magjistrati kryen shkelje disiplinore në këto raste: ... c) në mënyrë të pajustificuar kryen akte dhe sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë”; neni 103, pika e) përcakton se: “Sipas parashikimeve të shkronjës ‘c’, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si vijon: ‘... edhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme të pajustificuar’”. Pra, këto dispozita nga ana tjetër i konsiderojnë si shkelje disiplinore sjelljet e papërshtatshme të kryera në mënyrë të pajustificuar qoftë edhe jashtë ushtrimit të funksionit, duke mos i shteruar rastet e sjelljeve të tilla, por duke cituar “edhe raste të tjera ...”.

Për sa më lart, prapësimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse, prandaj Komisioni, bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura dhe në faktet e provuara gjatë hetimit se subjekti i rivlerësimit ka luajtur në mënyrë të vazhdueshme për disa vite me radhë në lojëra fati, edhe pas miratimit të ligjit nr. 84/2016, duke investuar para në këto lojëra nga të cilat ka krijuar varësi se shumën e fituar në lojëra fati prej 75.854 euro subjekti e ka tërhequr menjëherë nga llogaria bankare dhe nuk ka deklaruar as destinacionin e saj, as gjendjen *cash* të saj në asnjë DIPP, duke ngritur kështu dyshimin se këto para mund t’i ketë investuar në lojëra të tjera fati, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë etikën, integritetin, figurën e subjektit, si dhe shkallën e besueshmërisë së publikut te drejtësia.

## **C/1 FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT**

**1.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit, në periudhën 1.10.2003 – 30.11.2011, ka punuar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë<sup>38</sup>, gjatë së cilës në datën 18.6.2008 emërohet drejtues i kësaj prokurorie<sup>39</sup>. Nga data 1.12.2011 – aktualisht është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>40</sup>, ku për periudhën 1.12.2011 – 14.3.2016, ka ushtruar edhe funksionin e zv/drejtuesit të kësaj prokurorie<sup>41</sup>.

<sup>38</sup>Me Dekretin nr. \*\*\*, datë 15.10.2003, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë për emërim prokuror në stash dhe nr. \*\*\*, datë 11.10.2004 për emërim si prokuror (shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2004 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm).

<sup>39</sup>Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 18.6.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm.

<sup>40</sup>Me Dekretin nr. \*\*\*, datë 30.11.2011, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë (shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2011, të Prokurorisë së Përgjithshme).

<sup>41</sup>Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 1.12.2011, të Prokurorit të Përgjithshëm (i emërimin) dhe urdhrin nr. \*\*\*, datë 14.3.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm (i largimit nga detyra të zv/Drejtuesit të Prokurorisë Vlorë).

2. Subjekti i rivlerësimit, në formularin e vetëvlerësimit për vitet 2013 – 2016, ka deklaruar një shifër të përgjithshme 493 çështje të caktuara<sup>42</sup> dhe 437 çështje të përfunduara<sup>43</sup>. Për vitet 2014 – 2017 ka deklaruar 56 çështje të mbartura<sup>44</sup>.

3. Brenda periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesëmarrës në seminarin e zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës<sup>45</sup> me temë “Masat e sigurimit personal dhe problematikat që mbart seanca e shqyrtimit të tyre”, datë 3.4.2014, si dhe në 3 trajnime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës<sup>46</sup>. Bashkëlidhur ka depozituar edhe certifikatat përkatëse për këto trajnime.

4. Subjekti i ka bashkëlidhur formularit vendimin “Për vlerësimin e punës së prokurorit” e Prokurorit të Përgjithshëm, për periudhën 2012 – 2016, me vlerësimin “shumë mirë”, si dhe tri dokumente të përzgjedhura nga subjekti si në vijim:

**Dokumenti nr. 1** – kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, në ngarkim të të pandehurit E. D., akuzuar për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe mbajtje e armëve luftarake”, “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “vjedhje” dhe të pandehurit L. Z., akuzuar për veprën penale “vjedhje” me pasoja të rënda dhe më shumë se një herë.

1.1 Rrethanat e faktit: Procedimi penal është regjistruar mbi bazën e materialit referues nr. \*\*\*, datë 12.5.2016, të Komisarariatit të Policisë Vlorë, ku shtetasi M. Z. ka bërë kallëzim për vjedhjen e banesës së kushëririt të tij nga shtetasi L. Z. dhe E. D. Gjatë kontrollit të banesës nga policia, shtetasi E. D. është kapur në flagrancë nga policia me armë në dorë dhe iu gjet një qese me rreth 60 gr Cannabis Sativa.

1.2 Procedimit penal nr. \*\*\*, datë 6.6.2016, i është bashkuar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “vjedhje” në ngarkim të shtetasit E. D., i cili ka pranuar vjedhjen e një automjeti tip “Mercedes-Benz \*\*\*”. Në datën 7.7.2016, me procedimin nr. \*\*\* është bashkuar procedimi penal nr. \*\*\*, në ngarkim të shtetasit I. I. për veprën penale “vjedhje”.

1.3 Vlerësimi i subjektit: Në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, subjekti i rivlerësimit çmon se nga hetimet rezulton se shtetasi E. D. ka konsumuar elementët e figurës së veprave penale “prodhim dhe mbajtje të armëve luftarake”, “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” dhe “vjedhje”, ndërsa shtetasi L. Z. ka konsumuar elementët e veprës penale “vjedhje” më shumë se një herë dhe ka kërkuar gjykimin e tyre.

**Dokumenti nr. 2** – vendim për njoftim akuze. Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2015, me të pandehurit K. L. dhe B. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim të vulave dhe stampave apo formularëve” (neni 190/2 i Kodit Penal).

2.1 Nga hetimet ka rezultuar se shtetasi E. S., pasi ka ndërtuar katin 1 të një banese, e ka regjistruar në ZVRPP-në Vlorë në datën 14.10.2005. Më pas, për ndërtimin e dy kateve të tjera ka marrë kredi duke vënë garanci katin 1, por në pamundësi për ta shlyer kredinë, banka ia ka shitur katin 1 me ankand shtetasve K. dhe B. L., të cilët e kanë regjistruar në ZVRPP.

---

<sup>42</sup>Viti 2013 (96 procedime) ka përfaqësuar akuzën në gjykim në 19 procedime; 2014 (34) ka përfaqësuar akuzën në gjykim në 10 procedime; 2015 (86) ka përfaqësuar akuzën në gjykim në 25 procedime; 2016 (277) ka përfaqësuar akuzën në gjykim në 19 procedime.

<sup>43</sup>Në vitin 2013 (82 procedime); në 2014 (27); 2015 (76); 2016 (252).

<sup>44</sup>Në vitin 2014 ka mbartur nga viti 2013 (14 procedime); në vitin 2015 ka mbartur nga viti 2014 (7 procedime); 2016 ka mbartur nga viti 2015 (10 procedime); në vitin 2017 ka mbartur nga viti 2016 (25 procedime).

<sup>45</sup>Sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 26.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës.

<sup>46</sup>(1) “Mbrojtja e të dhënave personale dhe \*\*\*”, Sarandë 23-24 maj 2016; (2) “Aktivitetet e biznesit në tregjet financiare dhe mbrojtjen e kursimeve” pranë shkollës së policisë gjyqësore Romë-Itali datë 26.9.2011; (3) “Zhvillime të reja legislative në fushën e dhunës në familje, roli i gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë” Gjyrokastër në datën 16-17 prill 2007.

2.2 Zyra e ALUIZNI-t Vlorë konfirmon<sup>47</sup> se shtetasit K. dhe B. L. kanë aplikuar pranë kësaj drejtorie për legalizimin e objektit informal banesë me 2 kate duke paraqitur të dhëna të rreme, pasi në fakt investimi për ndërtimin e dy kateve të tjera është bërë nga shtetasi E. S.

**Dokumenti nr. 3** – vendim për pezullimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2014, i regjistruar për veprat penale “vrasje me dashje” dhe “prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 76 e 278/4 të Kodit të Procedurës Penale.

3.1 Rrethanat e faktit: Në datën 26.8.2014, shtetasi D. L. së bashku me shokun e tij L. H. janë nisur në malin e \*\*\*, Vlorë, për t'i dërguar ushqime dhe rroba babait të D. që ishte çoban në mal. Rreth orës 14:30 ata gjatë një debati me disa persona për të cilët kanë menduar se ishin hajdutë, njëri nga personat që mbante në dorë një automatik, qëllon në këmbë D., i cili bie përtokë me kurriz. Personi që e qëllon i shtiu sërish edhe dy herë të tjera në gjoks duke i shkaktuar vdekjen. Gjatë pyetjes, shtetasi L. H. ka deklaruar se nuk njihnte asnjë nga personat me të cilët u konfliktuan, por nëse do t'i shihte do të dallonte tre prej tyre, kurse autorin që vrau D. nuk e kishte parë qartë sepse mbante një kapele me strehë.

3.2 Vlerësimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit: Subjekti ka kryer të gjitha veprimet hetimore deri edhe kërkimin dhe gjetjen e 3 numrave celularë që janë loguar nga antenat e telefonisë celulare në zonën dhe datën e vendngjarjes. Në përfundim, subjekti citon se nga veprimet hetimore nuk është arritur identifikimi i autorit të veprës penale dhe bashkëpunëtorëve të tij. Lidhur me dyshimet se shtetasit K. K. dhe A. M. kanë qenë në afërsi të vendit të ngjarjes në kohën kur ka ndodhur ngjarja, subjekti ka çmuar që shërbimet e policisë gjyqësore të grumbullojnë të dhëna të tjera, me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore, mes të cilave edhe paraqitjen për njohje nga shtetasi L. H.. Për këtë arsye, subjekti ka vendosur pezullimin e procedimit penal.

Konkluzion: Në tri dokumentet e paraqitura nga subjekti nuk janë konstatuar problematika që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket aspektit profesional.

## **C/2 PESË DOSJET E PËRZGJEDHURA SIPAS NJË SISTEMI RASTËSOR DHE OBJEKTIV**

**Dosja nr. 1** – dokumenti ligjor “vendim datë 15.7.2016 për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 17.5.2016” dhe aktet e këtij kallëzimi penal të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

1.1 Rrethanat e faktit: procedimi penal nr. \*\*\*, datë 17.5.2016, është regjistruar nga Prokuroria për veprën penale “dhunë në familje”, mbi bazën e akteve të referuara në këtë datë nga Komisariati Vlorë, ku shtetasi S. A. ka bërë kallëzim. Ky shtetas pretendon se bashkë me vëllezërit e tij K. dhe Ç. A. kanë ndërtuar një objekt 4 kate “\*\*\*\*”. Gjatë sezonit veror 2015, vëllai i tyre B. A., i cili pretendon të drejtë bashkëpronësie mbi këtë pronë, ka hyrë në ndërtesë dhe ka marrë disa orendi dhe pajisje të restorantit, si dhe ka ndërruar bravat e dyerve.

1.2 Ndërtimi dhe investimi është bërë me shpenzime të përbashkëta të tyre, kurse aplikimi për legalizim është bërë në emër të 5 vëllezërve. Në deklaratimet e tyre, shtetasit B. dhe I. A. pretendojnë se nuk janë lejuar të përdorin këtë pronë nga vëllezërit e tyre K. dhe S. A. Në datën e kallëzimit ka rezultuar se prona zotërohet nga shtetasit K. dhe S. A.

1.3 Në dosje ndodhet edhe një kontratë noteriale dhurimi e vitit 1998, ku dhuruesit prindërit, dhe I. A. i dhurojnë pranuesve të dhurimit K. dhe S. A. pronën e blerë nga N.K. Banesa Sarandë në vitin 1993. Për këtë kontratë, znj. L. A. (nëna), në procesverbalin datë 1.6.2016, të marrjes së të

<sup>47</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2015, të ALUIZNI-t.

dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, deklaroi se kjo kontratë është e falsifikuar pasi nënshkrimi në këtë kontratë nuk është i saj. Në procesverbalin datë 11.5.2016 të personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi B. A. deklaroi se akti i blerjes së kësaj prone (pra, kontrata e vitit 1993) është i falsifikuar, pasi edhe pse është nënshkruar nga anëtarët e tjerë të familjes nuk është nënshkruar prej tij.

1.4 Vlerësimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit – subjekti, në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, arsyetoi se nga veprimet hetimore janë sqaruar faktet dhe rrethanat e mësipërme, si dhe janë grumbulluar prova të plota, ku nuk rezultoi të ketë elementë të veprave penale “dhunë në familje” dhe as “vetëgjyqësia”, ndërsa në lidhje me faktin e pretenduar të falsifikimit të kontratës së dhurimit dhe të kontratës së shitjes është parashkruar afati i ushtrimit të ndjekjes penale. Për këto arsye, bazuar në nenet 290 germa “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti e ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 17.5.2016, për veprat penale “dhunë në familje” dhe “vetëgjyqësia”, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, si dhe për rrethanat të tjera të parashikuara në ligj.

**Dosja nr. 2** – dokumenti ligjor “vendim datë 15.10.2014 për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 29.9.2014” dhe aktet e këtij kallëzimi penal të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

2.1 Komisioni, pasi shqyrtoi dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, të administruar nga KLP-ja, vëren se në datën 29.9.2014, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë dërguar materialet procedurale nga ku rezultoi se:

2.2 Rrethanat e faktit: nga veprimet hetimore ka rezultuar se në datën 23.9.2014 (ora 21:30) automjeti tip “BMW”, i drejtuar nga shtetasi A. A., ka qenë duke qarkulluar në drejtimin \*\*\*, Vlorë dhe në kryqëzimin e rrugës “\*\*\*\*” i është ndërprerë rruga nga automjeti tip “Volkswagen”, i drejtuar nga shtetasi A. P. dhe në pamundësi për të manovruar e ka përplasur në derën e parë. Nga procesverbali i këqyrjes së vendngjarjes rezultoi se automjetet kanë përshkruar të njëjtin itinerar dhe drejtuesit kanë qenë duke bërë manovrim për kthimin e mjeteve kur janë përplasur. Si rezultat, ka pasur dëmtime të dy automjeteve, dëmtime që kanë sjellë humbje të aftësisë së përkohshme për punë mbi 9 ditë të shtetasit A. P. dhe dëmtime që kanë sjellë humbje të aftësisë së përkohshme për punë deri 9 ditë të shtetasit O. Ç., bashkëshortja e A. Drejtuesit e automjeteve nuk kanë konsumuar alkool. Në procesverbalin datë 23.9.2014, shtetasi A. P. e pranon që i ka ndërprerë rrugën në mënyrë të menjëhershme automjetit të shtetasit A. A.

2.3 Vlerësimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit: Në arsyetimin e vendimit subjekti citon se nga ana objektive konstatohen veprime dhe mosveprime të shtetasve A. P. dhe A. A., që vijnë në kundërshtim me rregullat e qarkullimit rrugor, por nga ana tjetër u provua mungesa e elementit “pasojë” të figurës së veprës penale, pasi pasojat e ardhura janë plagosje e lehtë dhe dëmtime të tjera. Këto dëmtime nuk cilësohen si “pasojë” në këndvështrim të dispozitës penale përkatëse, nenit 290/1 të Kodit Penal. Bazuar në nenet 290/1, germa “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2014, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.

**Dosja nr. 3** – dokumenti ligjor “vendim datë 24.12.2015 për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*\*”.

3.1 Rrethanat e faktit: në datën 6.10.2015, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2015, për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë” neni 289 i Kodit Penal. Në datën 3.9.2015 është paraqitur në spital shtetasja B. K., e cila rreth orës 10:00, gjatë procesit të punës, ka rënë përtokë me pjesën e prapme të trupit duke pësuar dëmtime në kokë, etj., si dëmtime të rrezikshme për jetën në momentin e shkakimit.

3.2 Nga deklaramet e kësaj shtetaseje ka rezultuar se ajo është instruktuar për detyrat e saj, për rregullat e mbrojtjes në punë, si dhe është pajisur me uniformë, doreza e maska për mbrojtjen nga pluhuri. Ajo ka shpjeguar se vuante nga gjendrat tiroide prej 5 vjetësh sëmundje që i shkaktonte luhatje tensioni dhe marrje mendsh. Të njëjtin fakt ka pohuar edhe vëllai i saj gjatë pyetjes. Gjithashtu, znj. S. Ç, pronare e mobilierisë ku punon e dëmtuara, ka deklaruar se shtetasja B. K. ka filluar punë pranë mobilierisë dy ditë para aksidentit, kur edhe është instruktuar prej saj për procesin e punës.

3.3 Vlerësimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit: Subjekti, në pjesën arsyetuese të vendimit, arsyeton se në analizë të fakteve dhe provave të grumbulluara konkludohet se fakti nuk përmban elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Dëmtimi i shtetasës B. K. ka ardhur jo si rezultat i mosrespektimit të rregullave që kanë të bëjnë me punën, por për shkaqe shëndetësore. Subjekti ka vlerësuar se procedimi duhet të pushohet në kushtet e nenit 328, germa 1/b, pasi fakti nuk parashikohet si veprë penale për shkak të mungesës së lidhjes shkakësore.

**Dosja nr. 4** – dokumenti ligjor “vendim datë 20.11.2013 për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*”.

4.1 Rrethanat e faktit: në datën 20.8.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar këtë procedimin penal për veprën penale “mashttrim në sigurime” neni 145 i Kodit Penal, si dhe emrin e personit, të cilit i atribuohet fakti.

4.2 DRSSH-ja Vlorë, gjatë hedhjes së të dhënave të pensioneve sipas regjistrimit të tyre në regjistrin kombëtar të gjendjes civile, ka konkluduar se shtetasja H. A. ka përfituar padrejtësisht pension të parakohshëm pleqërie për periudhën 19.10.1994 – 19.2.1999, pasi në dosjen e pensionit ajo ka paraqitur një certifikatë familjare ku figuron e datëlindjes 19.19.1939, ndërkohë që referuar regjistrin elektronik të Gjendjes Civile është e datëlindjes 19.2.1944.

4.3 Vlerësimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit: Në pjesën arsyetuese të vendimit, subjekti citon se certifikata e gjendjes civile, e falsifikuar, rezulton të jetë përdorur prej kësaj shtetaseje për të përfituar pension deri në vitin 1999, kohë kur sipas ligjit ajo duhej në fakt që të dilte në pension pleqërie. Në vështrim të nenit 66/1, germa “c”, e Kodit Penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 191 i Kodit Penal, që nga koha e përdorimit të certifikatës së falsifikuar kanë kaluar më tepër se 5 vjet, pra ekziston një shkak që shuan veprën penale pasi janë plotësuar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale. Për këto arsye, bazuar në nenin 328, germa “d”, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal.

**Dosja nr. 5** – dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 11.9.2014”.

5.1 Rrethanat e faktit: mbi bazën e materialit referues të dërguar me shkresën nr. \*\*\*, datë 10.6.2014, të CEZ Shpërndarje sh. a., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 11.6.2014. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi A. H., në godinën ku ushtron aktivitetin privat, ka qenë debitor për energjinë elektrike të konsumuar në periudhën maj 2008 – maj 2014 dhe, për këtë, i është ndërprerë lidhja me energjinë elektrike sipas procesverbalit datë 19.4.2014. Pas një muaji gjatë verifikimit është konstatuar se shtetasi A. H. merrte energji elektrike pa lejen e furnizuesit nëpërmjet lidhjes së paligjshme.

5.2 Vlerësimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit: Subjekti arsyeton në kërkesën e tij se është provuar që shtetasi A. H. ka konsumuar elementët e veprës penale të vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike dhe kërkon gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2014 në ngarkim të të pandehurit A. H.

5.3 Në përfundim të gjykimit, subjekti ka kërkuar deklaramin fajtor të shtetasit A. H. për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim; aplikimin

e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe dënimin e tij me 2 muaj burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.11.2014, ka vendosur sipas kërkesës së subjektit dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.2.2016.

Konkluzion: Në pesë dokumentet e përzgjedhura nëpërmjet procedurës së shortit nuk janë konstatuar problematika që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket aspektit profesional.

### **C/3 TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

**1.** Nga verifikimi i të dhënave prej burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore, të dhëna apo *indicie* nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve dhe cenim të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë apo indirekt në veprime të dyshimta.

**2.** Nga verifikimi i të dhënave në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme<sup>48</sup> rezulton se me urdhër nr. \*\*\*, datë 15.3.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm subjekti është pezulluar nga detyra si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë deri në përfundimin e hetimeve paraprake, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2013, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, në ngarkim të subjektit dhe të shtetasit J. D.

**2.1** Në lidhje me rrethanat e ngjarjes, në datën 13.3.2013, për shkak të një defekti të papritur automjeti i subjektit ishte rimorkuar me kavo nga automjeti i shtetasit J. D. dhe në momentin kur kanë hyrë në rrethrotullim me drejtim \*\*\*, Vlorë, shtetasi A. Xh. që ka qenë duke kaluar rrugën ka tentuar të hyjë në hapësirën mes dy automjeteve dhe nuk e ka vënë re kavon duke u penguar dhe rrëzuar. Automjeti i subjektit, i tërhequr nga automjeti tjetër, i ka kaluar sipër duke i shkaktuar vdekjen. Viktima ka qenë 13 m larg vijave të bardha të anës së majtë të rrugës dhe 34 m larg vijave të bardha të anës së djathtë.

**2.2** Me vendimin datë 13.3.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka shpallur moskompetencën për procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2013, meqë njëri nga personat e përfshirë në aksident është prokuror në Prokurorinë e Rrethit Vlorë.

**2.3** Me vendimin datë 13.3.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka pranuar për kompetencë fashikullin hetimor nr. \*\*\*, viti 2013, të përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. \*\*\*, datë 13.3.2013, dhe ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2013.

**2.4** Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe në datën 18.4.2013 ka vendosur pushimin e procedimit penal ndaj subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit J. D.

**2.5** Nga aktet në dosje nuk rezulton që të jetë bërë ankim ndaj vendimit datë 18.4.2013 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për pushimin e procedimit penal.

**2.6** Nga shqyrtimi i dosjes së procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013, e administruar nga KLP-ja, rezulton e provuar se fakti nuk përbën vepër penale dhe nga subjekti nuk ka veprime që vijnë në kundërshtim me ligjin.

**3.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i konfirmon<sup>49</sup> KLP-së se ndaj subjektit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 1.4.2016, me objekt “shpërdorim detyre” dhe “fillim i

<sup>48</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2019, e Prokurorisë së Përgjithshme (Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve).

<sup>49</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

paligjshëm i ndjekjes penale” pas kallëzimit datë 30.3.2016, të bërë nga shtetasi K. A. pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

**3.1** Kallëzuesi K. A., në kallëzimin e tij pretendon se në vitin 2013, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të subjektit për veprat penale të parashikuara nga nenet 139 dhe 287/b të Kodit Penal dhe kjo çështje i është ngarkuar subjektit, i cili në kundërshtim me ligjin i ka njoftuar akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Sipas kallëzuesit, vepra penale nuk është kryer prej tij dhe qëllimi i prokurorit ka qenë thjesht gjetja e një autori të krimit të ndodhur. Me vendim gjyqësor, vendimi i prokurorit është prishur dhe shtetasi K. A. është shpallur i pafajshëm për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

**3.2** Nga shqyrtimi i dosjes së procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016 (i filluar ndaj subjektit të rivlerësimit) të administruar nga KLP-ja, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në gjykatë gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, që është bashkuar me procedimin penal nr. \*\*\*, datë 17.1.2013, të hetuar prej tij në ngarkim të disa shtetasve, përfshirë edhe shtetasin K. A. për veprat penale “vjedhje me dhunë” dhe “përfitim i parave ose mallrave të vjedhura” në bashkëpunim me shtetasin Sh. H. dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të municionit luftarak”, si dhe ka kërkuar në gjykim deklarimin fajtor të shtetasit K. A. dhe dënimin e tij për këto vepra penale.

**3.3** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.5.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shtetasin K. A. ka vendosur: deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale “përvetësim i parave dhe sendeve të vjedhura” dhe dënimin me 2 vjet e 6 muaj burgim; pushimin e gjykimit për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak” për shkak të ligjit të amnistisë nr. 22/2014, datë 10.3.2014; deklarimin e pafajshëm për veprën penale “vjedhje me dhunë” në bashkëpunim, pasi nuk provohet se ka kryer këtë vepër.

**3.4** Në lidhje me deklarimin e pafajshëm të shtetasit K. A. për veprën penale “vjedhje me dhunë”, gjykata arsyeton se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me kryerjen e kësaj vepre penale dhe të pranuar nga gjykata (deklarimet e shtetasve si më lart) nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën që të krijojnë bindjen se shtetasi K. A. është një nga autorët e veprës penale, prandaj akuza e ngritur kundër tij nuk është e bazuar. Pra, qoftë pretendimi i kallëzuesit, qoftë arsyetimi i gjykatës, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave në proces, aspekt ky që i përket anës materiale të procedimit dhe bindjes së vetë prokurorit, për të cilat Komisioni në bazë të pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 nuk ka kompetencë të hetojë.

**3.5** Në datën 16.5.2014, subjekti i rivlerësimit ka bërë ankim ndaj vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.5.2014, duke kërkuar ndryshimin e tij, shpalljen fajtor të të pandehurit K. A. për veprën penale “vjedhje me dhunë”, kryer në bashkëpunim dhe dënimin për këtë vepër penale.

**3.6** Në vendimin datë 2.5.2016 për mosfillimin e procedimit penal ndaj subjektit në lidhje me akuzat që ka ngritur kundër tij shtetasi K. A. për “shpërdorim detyre” dhe “fillim i paligjshëm i ndjekjes penale”, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier arsyeton se ngritja e akuzës është kompetencë vetëm e prokurorisë dhe dispozitat procedurale penale parashikojnë mënyrën, afatet sesi kundërshtohet vendimmarrja e organit të prokurorisë. Bazueshmëria apo jo në ligj e veprimtarisë së prokurorit i nënshtrohet vetëm kontrollit gjyqësor. Pra, fakti nuk përbën vepër penale dhe në këto rrethana procedimi nuk duhet të fillojë.

Për sa më lart, nuk u konstatuan veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit që e ngarkojnë atë me përgjegjësi apo që tregojnë mangësi në aftësitë profesionale të tij.



**4.** Komisioni administroi përgjigjet e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore<sup>50</sup> dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2020, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ku rezultoi se ndaj subjektit nuk ka çështje penale të filluara, të pushuara apo të gjykuara, as kontakte me persona të papërshtatshëm, ndërsa sipas përgjigjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier konfirmohet<sup>51</sup> se kjo prokurori ka regjistruar ndaj subjektit të rivlerësimit kallëzimin penal nr. \*\*\* të shtetasit I. A., të depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 9.12.2019 dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 26.12.2019, si dhe ka dërguar kopje të fashikullit të mosfillimit.

**4.1** Nga aktet bashkëlidhur përgjigjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe aktet e dërguara<sup>52</sup> prej saj, rezultoi se kjo prokurori ka regjistruar për kompetencë kallëzimin nr. \*\*\* të shtetasit I. A. për veprën penale “shpërdorim detyre” ndaj prokurorit Alfred Sali dhe gjyqtarës A. Z.

**4.2** Në kallëzimin e tij, shtetasi I. A. pretendon se është prangosur në banesën e tij nga punonjësit e policisë sepse u ka kërkuar atyre të dalin jashtë kur kanë ardhur t’i njoftojnë urdhrin e mbrojtjes, të cilin nuk ka dashur ta marrë, ndërsa prokurori Alfred Sali dhe gjyqtare A. Z. e kanë akuzuar dhe dënuar padrejtësisht.

**4.3** Nga vendimi nr. \*\*\* , datë 15.4.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (nënshkruar nga gjyqtarja e çështjes A. Z.) rezultoi e provuar edhe nga dëshmitë në seancë gjyqësore se 3 punonjësit e policisë së Komisarariatit \*\*\* që kanë shkuar në banesën e të pandehurit I. A. për t’i komunikuar një urdhrë mbrojtjeje janë kundërshtuar nga i pandehuri duke i shtyrë ata, duke u përleshur me duar dhe duke përdorur fjalë fyese ndaj tyre. Gjykata ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit I. A. për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe dënimin me 1 vit burgim. Prokuroria e Rrethit Vlorë është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit.

**4.4** Me vendimin datë 26.12.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* ndaj subjekteve të rivlerësimit Alfred Sali dhe A. Z., për shkak se fakti objekt kallëzimi nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Gjatë arsyetimit në vendim, prokuroria citon se vendimet e prokurorit dhe të gjykatës janë objekt shqyrtimi dhe kontrolli nga ana e gjykatës, si i vetmi organ që vlerëson vendimet e tyre. Në dosje nuk rezultoi të ketë ankim të kallëzuesit ndaj vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*.

Për sa më lart, nuk u konstatuan veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit që e ngarkojnë atë me përgjegjësi apo që tregojnë mangësi në aftësitë profesionale të tij.

**5.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë konfirmon<sup>53</sup> se figuron të jetë regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, procedim i cili në datën 13.3.2013 është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku përmendet emri i subjektit Alfred Sali (trajtuar në pikën C/3, pika 2 më lart).

---

<sup>50</sup>Shkresat e Prokurorive të Rrethit Gjyqësor: Pogradec nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020; Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2020; Lushnjë nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020; Mat nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020; Elbasan nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020; Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2020; Krujë nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2020; Durrës nr. \*\*\* prot., shkurt 2020; Gjirokastrë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020; Korçë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020; Pukë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020; Tropojë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020; Kavajë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020; Kurbin nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020; Përmet nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020; Kukës nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020; Berat nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020; Sarandë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020.

<sup>51</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020, e Prokurorisë së Rrethit Fier.

<sup>52</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>53</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2020, e Prokurorisë së Rrethit Vlorë.

**6.** Prokuroria e Përgjithshme, Sektori i Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë konfirmon<sup>54</sup> se për subjektin nuk ka ardhur nga agjenci ligjzbatuese asnjë informacion që bën fjalë për *indicie* apo cenim të figurës së tij.

**6.1** Prokuroria e Përgjithshme konfirmon<sup>55</sup> se për subjektin e rivlerësimit ka një ankesë nr. \*\*\*, në vitin 2018, nga shtetasi Rr. D. Në ankesë, ky shtetas pretendon që: *“Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka depozituar kallëzimin penal nr. \*\*\*, në datën 19.12.2017, për të cilin subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, qëllimisht, në vitin 2018 dhe jo në datën që e ka depozituar kallëzuesi. Prokurori nuk e ka thirrur të japë shpjegime për kallëzimin dhe provat që i ka bashkëlidhur kallëzimit; ka zvarritur hetimet; nuk ka vendim për shtyrje të afatit të hetimeve dhe e ka pushuar çështjen pas 7 muaj e 12 ditë nga data e depozitimit të kallëzimit”*. Bashkëlidhur ankesës, ankuesi ka depozituar kallëzimin penal të datës 19.12.2017 dhe disa akte të tjera<sup>56</sup>.

**6.2** Nga aktet e depozituara nga kallëzuesi dhe nga fashikulli i procedimit penal nr. \*\*\*, datë 20.12.2017, të administruar<sup>57</sup> nga Komisioni, rezulton se: Në vitin 2017, Rr. D. depozitoi kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 19.12.2017, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprat penale “shkatërrim prone” dhe “pushtim i tokës” ndaj shtetasve S. A., Xh. A., Y. A. dhe M. A. Në datën 3.1.2018 u regjistrua procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “pushtim i tokës”. Çështja është hetuar nga dy subjekte të tjera rivlerësimi (E. M. dhe E. L.) dhe në datën 18.1.2018 i është caktuar për ndjekje subjektit të rivlerësimit Alfred Sali.

**6.3** Pra, procedimi penal është regjistruar 15 ditë pas regjistrimit të kallëzimit nr. \*\*\*, nga një prokuror tjetër dhe jo nga subjekti i rivlerësimit Alfred Sali, siç pretendon ankuesi.

**6.4** Me vendimin datë 26.7.2018, subjekti i rivlerësimit, në bazë të germës “F”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e procedimit penal për veprën penale “pushtim i tokës” me arsyetimin se nga analiza e akteve të administruara në materialin kallëzues dhe nga mënyra e zhvillimit të ngjarjeve, evidentohet mungesa e elementëve të veprës penale “pushtim i tokës”, si dhe konflikti duhet të zgjidhet në rrugë administrative në bazë të nenit 21, të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar.

**6.5** Pra, hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë zgjatur rreth 7 muaj nga data e regjistrimit të procedimit penal. Pika 2, e nenit 323, të Kodit të Procedurës Penale përcakton se: *“Afati i përfundimit të hetimeve është 3 muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale”*. Nga aktet rezulton që deri në datën 26.7.2018, kur subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal, nuk ka urdhër për të regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Sipas kësaj dispozite, subjekti nuk ka zgjatur afatin e hetimeve dhe as nuk ka pasur detyrimin për të disponuar me vendim shtyrjen e këtij afati, siç pretendon shtetasi Rr. D. në ankesën e tij.

**6.6** Me vendim nr. \*\*\*, datë 22.10.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit datën 26.7.2018 të subjektit “Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*” dhe kthimin e akteve prokurorit. Vendimi i gjykatës është lënë në fuqi nga vendimi nr. \*\*\*, datë 17.12.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë. Në vendimin e saj gjykata ka orientuar që prokurori, bazuar në aktekspertimin e depozituar dhe në pretendimet e kallëzuesit, duhet të kryejë hetime edhe për veprën penale “shkatërrim i pronës”, duhet të pyetet kallëzuesi, të administrohen vendimet

<sup>54</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme.

<sup>55</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëlidhur ankimi.

<sup>56</sup>Vendim pushimi të çështjes datë 26.7.2018 të subjektit; vendim nr. \*\*\*, datë 3.2.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; vendim nr. \*\*\*, datë 5.2.2015, i Gjykatës së Apelit Vlorë; vendim nr. \*\*\*, datë 20.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; vendim nr. \*\*\*, datë 12.2.2010, i Gjykatës së Lartë; vendim nr. \*\*\*, datë 6.10.2011, i Gjykatës së Lartë.

<sup>57</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

gjqësore penale e civile të formës së prerë për konfliktin midis palëve si dhe të merren e provave të tjera nëse çmohet e nevojshme.

**6.7** Pasi rifilloi hetimi, në datën 18.12.2020 subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e emrave të personave që i atribuohet vepra penale (S., Xh., M. dhe Y. A.) dhe në datën 1.2.2021 i ka kërkuar gjykatës dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. \*\*\*. Pra, referuar pikës 2, të nenit 323, të Kodit të Procedurës Penale si më lart, afati i hetimeve ka zgjatur 1 muaj e gjysmë nga data në të cilën emrat e personave që u atribuohet vepra penale janë regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Në shkresën nr.\*\*\* prot., datë 20.5.2022, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë konfirmon se çështja është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilën vazhdon gjykimi.

**6.8** Nga veprimet hetimore të kryera para se subjekti të caktohej për ndjekjen e këtij procedimi, por edhe më pas, rezulton se kallëzuesi Rr. D. nuk është thirrur asnjëherë për t'u pyetur e për të dhënë shpjegime rreth kallëzimit që ka bërë, deri në datën 26.7.2018, kur subjekti ka disponuar me vendim pushimi të procedimit penal, duke vepruar në kundërshtim me pikën 1, të nenit 312, të Kodit të Procedurës Penale. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**6.9** Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se nuk e ka pyetur shtetasin Rr. D. pasi në vlerësimin e tij, bazuar në disa akte të administruara (vendime gjyqësore penale dhe civile, vendime pushimi të prokurorisë, me të cilat është trajtuar më parë ky konflikt), qartësohej dhe provohej natyra e konfliktit civil dhe qëllimi i subjektit ka qenë që çështjes t'i jepej zgjidhja e duhur ligjore. Shtetasi Rr. D. rezulton se është pyetur në fazën e hetimit paraprak (procesverbal për marrjen e të dhënave i mbajtur prej OPGJ I. H., f. \*\*\*, fashikulli i parë i procedimit, kopje të të cilit e paraqet si provë).

**6.10** Gjithashtu, subjekti shpjegon se meqenëse vendimi i pushimit datë 26.7.2018, që ai ka marrë, është shfuqizuar nga gjykata (pra, është nul), nuk mund të konsiderohet si shkelje, moskryerja e një veprimi në kohë, në referencë të një vendimi përfundimtar, i cili nuk është më i tillë, pra është nul.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**6.11** Referuar fashikujve të procedimit penal që Komisioni ka administruar, rezulton se pas regjistrimit të këtij procedimi në datën 3.1.2018 janë kryer disa veprime hetimore për administrimin e shumë akteve që kanë lidhje me këtë konflikt, por referuar procesverbaleve të datave 15.2.2018, 16.2.2018, 19.2.2018 janë thirrur nga OPGJ-ja për t'u pyetur dhe për të marrë të dhëna shtetasit Y., M. dhe S. A. në zbatim të urdhrave datë 6.2.2018, të firmosura nga subjekti për thirrjen e këtyre shtetasve. Gjithashtu, me urdhër datë 6.2.2018 të subjektit janë thirrur për t'u pyetur edhe shtetasit R. A. dhe P. Gj. Pra, subjekti ka zhvilluar hetime duke thirrur disa persona, por nuk i ka dhënë të drejtën për t'u pyetur dhe për të dhënë shpjegime, pikërisht, shtetasit Rr. D. që ishte dëmtuar dhe që kishte bërë kallëzimin. As pretendimi i subjektit se nuk e ka pyetur këtë shtetas meqë bazuar në disa akte të administruara (vendime gjyqësore penale e civile, vendime pushimi të prokurorisë, që kanë trajtuar më parë këtë konflikt) qartësohej dhe provohej natyra e konfliktit civil nuk është bindës për Komisionin, ndërkohë që subjekti për 7 muaj ka kryer mjaft veprime të tjera hetimore për të provuar se konflikti kishte natyrë civile dhe çuditërisht nuk i është dashur të merrte në pyetje shtetasin Rr. D.

**6.12** Në referim të dispozitës që Komisioni ka cituar në konstatimin e tij, si dhe të parimeve procedurale për një proces të rregullt ligjor, subjekti i ka mohuar një të drejtë procedurale shtetasit

Rr. D., duke mos e vënë atë në pozitë të barabartë me shtetasit e tjerë, të cilët i ka thirrur për të dhënë shpjegime gjatë hetimit. Procesverbali për marrjen e të dhënave, i mbajtur prej OPGJ-së I. H., që subjekti ka depozituar bashkëlidhur prapësimëve, është mbajtur në datën 3.11.2020, pra pasi subjekti ka disponuar me vendimin datë 26.7.2018 për pushimin e procedimit penal dhe pasi u riçel hetimi me vendim gjyqësor.

**6.13** Gjithashtu, pretendimi i subjektit se mosmarrja në pyetje e shtetasit Rr. D. nuk përbën shkelje, meqenëse vendimi i pushimit datë 26.7.2018 është nul sepse është shfuqizuar nga gjykata, nuk e ligjëron shkeljen procedurale që subjekti ka kryer, përkundrazi, një nga arsytet pse gjykata ka shfuqizuar këtë vendim dhe ka urdhëruar riçeljen e hetimit është “mosmarrja në pyetje e shtetasit Rr. D.” dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për riçeljen e hetimit është lënë në fuqi edhe nga Gjykata Apelit Vlorë, çka e përforcon bindjen e Komisionit se veprimet e subjektit kanë qenë në shkelje të ligjit procedural.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se kallëzuesi Rr. D. nuk është thirrur asnjëherë për t’u pyetur e për të dhënë shpjegime rreth kallëzimit që ka bërë, deri në datën 26.7.2018, kur subjekti ka disponuar me vendim pushimi të procedimit penal, duke vepruar në kundërshtim me: nenin 312 të Kodit të Procedurës Penale; ligjin nr. 97/2016, nenet 4 dhe 8 që respektivisht përcaktojnë se: *“Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik”*; *“Prokurorët sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, origjinës shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera”*.

## **DENONCIME**

### **6.14 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 31.3.2022, i shtetasit A.A.**

**6.15** Në denoncimin e tij ky shtetas pretendon se djali i tij A. A. është ndaluar në datën 13.9.2019 dhe në datën 15.9.2019 është kërkuar arrestimi i tij si i dyshuar për 3 vepra penale “moskallëzim krimi” dhe “përkrahje e autorëve pas kryerjes së krimit” për të njëjtin fakt, tentativë vrasje, e ndodhur në Vlorë, në datën 10.5.2019, si dhe “krijimi i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje” për një episod në Tiranë. Pas marrjes si të pandehur, në aktin e njoftimit të akuzës i njoftohen dy akuza: “moskallëzim krimi” dhe “përkrahje e autorëve pas kryerjes së krimit”. Denoncuesi pretendon edhe që me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i konfirmon se shtetasi A. A. nuk ka pasur akses në sistemet *TIMS*, *RIMS* dhe *ADAMS*, por vetëm në sistemin “E-gjoha” të policisë rrugore.

Në vijim, denoncuesi pretendon për shkelje procedurale sepse arrestimi i shtetasit A.A. është bërë mbi bazën e një deklarimi që është marrë në kundërshtim me nenin 32 të Kodit të Procedurës Penale.

Prokurori Alfred Sali nuk ka ngritur akuzë për veprat penale “moskallëzim krimi” dhe “përkrahje e autorëve pas kryerjes së krimit” ndaj shtetasve D. S. dhe N. Sh..

Denoncuesi pretendon edhe që në datën 27.7.2021 çështja u ankimua në Apel. Në shtator aktet për akuzën “sigurimi i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje” u transferuan në Prokurorinë e Rrethit Tiranë për moskompetencë tokësore, veprim ky i kryer në kundërshtim me nenin 82 të Kodit të Procedurës Penale. Aktet e kësaj akuze u mbajtën nga prokurori Alfred Sali për 2 vjet dhe më pas ai “u kujtua” të shpallë moskompetencën tokësore.

**6.16** Komisioni, pasi administroi<sup>58</sup> dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2021 dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>59</sup>, vëren se:

**6.17** Subjekti, me urdhrin datë 10.5.2019, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\* në maj të vitit 2019 për veprat penale “vrasje në rrethana cilësuese”, kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”. Me vendimin datë 23.10.2020, subjekti e ka ndarë këtë procedim penal në dy procedime penale: (i) nr. \*\*\*, ndër të tjera, në ngarkim të shtetasve Xh. M. dhe A. A. për veprat penale “moskallëzim krimi” e “përkrahje e autorit të krimit”; (ii) nr. \*\*\* për veprën penale “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e vrasjes”, kryer në bashkëpunim (nenet 25 dhe 80 të Kodit Penal) në ngarkim të shtetasve A. A., etj.

**6.18** Në vendimin datë 23.10.2020, subjekti arsyeton se për procedimin penal nr. \*\*\* nevojiten edhe veprime të tjera hetimore.

**6.19** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se nga tërësia e rrethanave duket që ndarja e çështjes në dy procedime penale nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* është bërë me qëllim për të lehtësuar pozitën procedurale në raport me llojin dhe masën e dënimit të veprës penale, të personave të akuzuar që kanë kryer në bashkëpunim disa vepra penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**6.20** Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron për disa arsye. *Së pari*, në fazën e hetimit, veprimet hetimore për veprat penale “vrasje në rrethana cilësuese”, kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, “moskallëzim i krimit” dhe “përkrahje e autorit të krimit”, ishin të plota për të pandehurit. *Së dyti*, për të pandehurit A. A., etj., në lidhje me veprën penale “sigurim i kushteve për vrasje”, kryer në bashkëpunim, dyshohej se ishte kryer në territorin e Rrethit Tiranë, por edhe jashtë shtetit për episode të caktuara të saj. Hetimet për këtë vepër penale, si procedim i lidhur (nenet 82 dhe 84 të Kodit të Procedurës Penale), nuk ishin të plota dhe nuk ishin mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme për përcaktimin e faktit dhe veprës penale, si dhe për individualizimin e përgjegjësisë penale të personave të dyshuar, çka kushtëzonte vijimin e hetimit paraprak për këtë vepër penale. *Së treti*, në këndvështrim të nenit 263/1, germa “c”, e Kodit të Procedurës Penale, afatet 1-vjeçare të kohëzgjatjes së paraburgimit në fazën e hetimit për shtetasit D. E. dhe A. G. (të arrestuar në datën 13.11.2019) mbaronin në datën 13.11.2020. Duke llogaritur edhe afatin 10-ditor të parashikuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, si afat që i lihet të pandehurit pas njoftimit të përfundimit të hetimit, veprimet hetimore me këta të pandehur duhet të përfundonin deri më 2.11.2020, në mënyrë që të mundësohej dërgimi i dosjes në gjykatë më 13.11.2020. *Së katërti*, kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim të procedimit penal nr. \*\*\* është pranuar nga gjyqtari i hetimit paraprak të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim të procedimit penal nr. \*\*\* është pranuar nga gjyqtari i hetimit paraprak të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. *Së pesti*, vendimi për ndarjen e procedimeve nuk ka ndikuar në akuzat e ngritura ndaj shtetasve A. A., etj., të cilët janë gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe po gjykohen për të njëjtat akuza në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pra, nuk rezulton të ketë pasur ndryshim të akuzës për asnjë prej të pandehurve, në drejtim të lehtësimit të tyre qoftë në fazën e hetimit ashtu edhe në atë të gjykimit. *Së gjashti*, sikurse konstatohet nga

<sup>58</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>59</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

aktet e fashikullit të gjitha kërkesat me objekt zëvendësimit të masave të sigurimit janë kundërshtuar në seancë dhe më pas janë ankimuar nga subjekti në Gjykatën e Apelit. Pra, dhe në këtë drejtim nuk ka pasur lehtësim të pozitës së të pandehurve. *Së shtati*, sikurse rezultoi dhe nga vendimi nr. \*\*\*, datë 8.7.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesat e subjektit për masën e dënimit ndaj shtetasve A. A., etj., janë mbi mesataren e masës së dënimit të parashikuar nga dispozitat përkatëse.

**6.21** Për sa më lart, subjekti pretendon që konstatimi i Komisionit se subjekti, duke bërë ndarjen e procedimeve penale, ka lehtësuar pozitën e të pandehurve është i gabuar.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**6.22** Referuar arsyeve që parashtrori subjekti në prapësime, akteve të fashikullit penal, si dhe duke mbajtur parasysh afatet procedurale në fazën e hetimit, parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale dhe detyrimin ligjor të prokurorit, parashikuar në udhëzimin nr. \*\*\*, datë 9.10.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, pika 1 e nenit 13 që përcakton se *prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore marrin të gjitha masat të planifikojnë në mënyrë efikase veprimet e duhura procedurale pa shkaktuar zvarritje të hetimeve, me qëllim përfundimin e tyre brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale*, Komisioni vlerëson se prapësimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme dhe bindëse. Për këto arsye, Komisioni arrin në përfundimin që me vendimin e tij për ndarjen e dy procedimeve penale, subjekti i rivlerësimit nuk ka lehtësuar pozitën procedurale në raport me llojin dhe masën e dënimit të veprës penale, të personave të akuzuar që kanë kryer në bashkëpunim disa vepra penale.

**6.23** Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se *ka shkelje procedurale pasi arrestimi i A. A. është bërë mbi bazën e një deklarimi që është marrë në kundërshtim me nenin 32 të Kodit të Procedurës Penale*, Komisioni vëren se me kërkesën datë 15.11.2019 “Për vlerësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit”, subjekti ka kërkuar vlerësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin A. A., i dyshuar për veprat penale “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje” kryer në bashkëpunim dhe “përkrahje e autorit të krimit”. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, është pranuar edhe kërkesa e subjektit. Pra, arrestimi është vlerësuar i ligjshëm.

Për sa më lart, për këtë moment procedural, Komisioni nuk konstaton veprime të parregullta të subjektit të rivlerësimit.

**6.24** Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se *subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur akuzë për veprat penale “moskallëzim krimi” dhe “përkrahje e autorëve pas kryerjes së krimit” ndaj shtetasve D. S. dhe N. Sh. edhe pse këta kanë deklaruar vetë që u kanë gjetur autorëve të dyshuar të krimit shtëpi për t’i strehuar në Tiranë duke dhënë adresën e saktë të shtëpisë, por prokurori nuk ka bërë asnjë verifikim për këtë rast*, Komisioni vëren se:

**6.25** Me urdhrin datë 15.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e emrave të shtetasve D. S. dhe N. Sh. në kolonën përkatëse të procedimit penal nr. \*\*\*, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje”, kryer në bashkëpunim dhe “moskallëzim i krimit”. Pas ndarjes së këtij procedimi në dy procedime (nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*) subjekti ka kërkuar në gjykatë gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\* në ngarkim edhe të shtetasve D. S. dhe N. Sh. për veprën penale “moskallëzim krimi” dhe gjykata ka dhënë dënimin për këtë vepër, kurse procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e vrasjes”, kryer në bashkëpunim (nenet 25 dhe 80 të Kodit Penal), në

ngarkim të shtetasve A. A., D. S. dhe N. Sh. është dërguar për kompetencë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pra, sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit e ka ngritur akuzën ndaj shtetasve D. S. dhe N. Sh. për veprën penale “moskallëzim krimi”.

**6.26** Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se *në shtator 2021 aktet për akuzën “sigurim i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje” u transferuan në Prokurorinë e Rrethit Tiranë për moskompetencë tokësore, veprim ky i kryer në kundërshtim me nenin 82 të Kodit të Procedurës Penale dhe aktet e kësaj akuze u mbajtën nga prokurori Alfred Sali për 2 vjet dhe më pas ai “u kujtua” të shpallë moskompetencën tokësore, Komisioni vëren se:*

**6.27** Në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\* “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje” kryer në bashkëpunim në ngarkim të shtetasve A. A., etj., subjekti, me vendimin datë 22.9.2021, ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë Tiranë.

**6.28** Bazuar në tërësinë e provave si: procesverbalet “Për deklarime nga personi që ka dijani për rrethanat e hetimit”; informacioni datë 14.11.2019 i DPV Vlorë drejtuar Prokurorisë Vlorë; procesverbali datë 22.11.2019 “Për këqyrjen e aparatit celular të A. A.”; në deklarimet e të pandehurve dhe nga përgjimet e bisedave telefonike, Komisioni vëren se veprimet hetimore për të evidentuar faktet (veprimet kanë ndodhur në qytetin e Tiranës ku ka qenë asokohe edhe vendbanimi i këtyre) që përmbushin kriteret e përcaktuara nga neni 76 i Kodit të Procedurës Penale për transferimin e kompetencës tokësore një prokurorie tjetër, janë kryer brenda vitit 2019.

**6.29** Vendimi “Për shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë Tiranë” është marrë më 22.9.2021. Referuar datës 15.11.2019 kur subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin në kolonën përkatëse të procedimit penal nr. \*\*\*, të emrave D. S. dhe N. Sh., të dyshuar për kryerjen e veprave penale “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje” kryer në bashkëpunim, si dhe datës 22.9.2021 kur iu kaluan aktet Prokurorisë së Rrethit Tiranë, kanë kaluar rreth 2 vjet.

**6.30** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit që duket se subjekti ka zvarritur marrjen e vendimit për moskompetencën e Prokurorisë së Rrethit Vlorë për hetimin e këtij procedimi penal dhe transferimin e dosjes në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me pikën 1, të nenit 84, të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**6.31** Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë parashikimet e neneve 82 dhe 84 të Kodit të Procedurës Penale, që rregullojnë kompetencën tokësore për procedimet e lidhura dhe parashikojnë se kompetenca tokësore për procedimet e lidhura për të cilat disa gjykata (prokurori në fazën e hetimit paraprak) kanë të njëjtën kompetencë lëndore i përket gjykatës kompetente për veprën penale më të rëndë (prokurorisë në fazën e hetimit). Nga aktet e hetimit paraprak rezulton se vepra penale më e rëndë është ajo e parashikuar nga nenet 79/dh, 22 dhe 25 të Kodit Penal dhe për këtë shkak, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka pasur kompetencë edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 80 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve A. A., etj., deri në momentin kur kanë përfunduar të gjitha veprimet hetimore të mundshme për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/dh 22, 25, 278, 300 dhe 302 të Kodit Penal dhe kur subjekti ka proceduar me ndarjen e çështjes në dy procedime.

**6.32** Gjithashtu, subjekti shpjegon se: *së pari*, nisur nga dinamika e hetimit të këtij procedimi penal, rëndësia e fakteve, numrit të personave të përfshirë, si dhe nga fakti se shtetasit A. A., etj., dyshoheshin për vepra penale, për të cilat hetimet po kryheshin në një procedim të lidhur, do të dëmtohej hetimi në tërësi i çështjes; *së dyti*, meqenëse dyshohet se veprat penale ishin kryer pjesërisht jashtë shtetit, ishte e domosdoshme marrja e të dhënave nga shoqëritë ajrore, autoritetet përkatëse të huaja, etj., të dhëna që janë administruar përgjatë viteve 2020 -2021, referuar korrespondencës së periudhës 27.3.2020 – 22.7.2021, nëpërmjet së cilës janë administruar akte nga Interpoli dhe shteti turk për ndihmë juridike në lidhje me itinerarin e udhëtimit të shtetasve, pjesë e këtij procedimi.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**6.33** Në lidhje me këtë prapësim, Komisioni risjell në vëmendje se subjekti ka vendosur qysh në datë 23.10.2020 ndarjen e procedimit penal nr. \*\*\* (madje në datën 5.11.2020 subjekti ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. \*\*\* në ngarkim të të pandehurve përkatës), nga procedimi nr. \*\*\* në ngarkim të shtetasve A. A., etj., për veprën penale “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje”, kryer në bashkëpunim dhe informacioni që ka kërkuar nga Interpoli dhe autoritetet e drejtësisë së shtetit të Turqisë nuk ka lidhje me këta shtetas. Ndërkohë, veprimet hetimore në lidhje me shtetasit A. A., etj., janë përfunduar brenda vitit 2019 dhe për këto arsye vendimi i datës 22.9.2021 “Për shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë Tiranë” është marrë pas një periudhe të gjatë, pasi subjekti ka kryer hetimet e fundit për shtetasit A. A., etj., duke zvarritur kështu marrjen e këtij vendimi.

Për sa më lart, pretendimet e subjektit nuk janë bindëse dhe Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka zvarritur marrjen e vendimit për moskompetencën e Prokurorisë së Rrethit Vlorë për hetimin e këtij procedimi penal dhe transferimin e dosjes në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me pikën 1, të nenit 84, të Kodit të Procedurës Penale.

### **6.34 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2022, i shtetas E. T.**

Ky denoncim ka ardhur në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2022, të Kolegjit. Denoncuesja pretendon se *është trashëgimtare e familjes V. dhe nëna e saj i ka dhënë prokurë të plotë nipit të tyre A. D. që të merrej me procedurat e kthimit e kompensimit të pronave të trashëguara. Duke shpërdoruar besimin, A. D. ka tjetërsuar këto prona në emër të avokatit A. D. dhe dy avokatëve të tjerë, nëpërmjet kontratave fiktive dhe pa paguar asnjë qindarkë me qëllim vjedhjen e këtyre pronave në bashkëpunim me këta persona. Çështjet penale në ngarkim të këtyre personave janë hetuar dhe gjykuar në Prokurorinë dhe Gjykatën e Tiranës, ndërsa çështja penale në ngarkim të avokatit A. D., u nda dhe u transferua në Vlorë, ku hetimet i ka kryer prokurori Alfred Sali dhe kjo çështje përfundoi shumë shpejt brenda një viti deri në tetor 2021. Në vijim, denoncuesja citon se: “... pavarësisht se 34 fashikujt hetimorë ishin plot me prova që mbështesnin akuzën, pasi përfundoi çështjen në shkallë të parë brenda një muaji, A. D. arriti të bindë prokurorin Alfred Sali për pafajësinë e tij dhe ky i fundit nuk bëri ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë”.*

**6.35** Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 12.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>60</sup> dhe shkresës nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2021, që kjo gjykatë i ka dërguar Gjykatës së Apelit Vlorë, akte këto të administruara nga Komisioni, rezulton se trashëgimtarët e familjes V. i i kanë dhënë kushërit të tyre A. D. disa prokura në nëntor 2008 dhe prill 2009 për të vepruar në emër dhe për llogari të tyre me pronat e trashëguara nëpërmjet procesit të njohjes, kthimit e kompensimit. Disa

<sup>60</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.



prej tyre i kanë dhënë edhe tagrin që të disponojë dhe të dhurojë pasuritë e tyre. Në vitin 2009 ky shtetas kryen disa transaksione për tjetërsimin e pronave të persona të tretë. Në vitin 2010, trashëgimtarja N. D. i revokon prokurën dhe pretendon se ia ka njoftuar revokimin shtetasit A. D. nëpërmjet *e-mail*-it. Rezulton se nuk është provuar fakti i njoftimit të revokimit. Në vitin 2012, me akt noterial revokojnë prokurën e tyre edhe disa trashëgimtarë të tjerë, të cilët ia njoftojnë revokimin përfaqësuesit të tyre, me postë rekomande me njoftim marrje.

**6.36** Në prill 2010, shtator 2012, prill 2014, shtetasi A. D. lidh me të pandehurin A. D. disa kontrata për tjetërsimin e disa pronave të kësaj familjeje (të ndodhura në Vlorë dhe Elbasan) në favor të të pandehurit A. D.

**6.37** Në lidhje me këtë çështje ka një kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Elbasan dhe disa kallëzime në Prokurorinë e Rrethit Vlorë, për të cilat është disponuar me vendime për pushim procedimi.

**6.38** Kallëzimi i fundit është bërë pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, e cila fillimisht ka filluar procedimin e kësaj çështjeje në ngarkim të disa shtetasve, midis të cilëve edhe ndaj shtetasit A. D., e më pas e ka transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Tiranë.

**6.39** Gjatë seancës paraprake mbi gjykimin e kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim, Gjykata e Rrethit Gjiqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.3.2021, ka vendosur: ndarjen e çështjes penale nr. \*\*\* për të pandehurin A. D. nga çështja në ngarkim të të pandehurve të tjerë; shpalljen e moskompetencës tokësore për gjykimin e kërkesës penale me objekt “Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. \*\*\* për të pandehurin A. D.; dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Vlorë si gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

**6.40** Gjykata e Rrethit Gjiqësor Vlorë ka gjykuar në seancë paraprake kërkesën dhe ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Vlorë, e përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit për dërgimin e çështjes për gjykim pranë kësaj gjykate.

**6.41** Gjatë gjyimit të themelit të çështjes personat e interesuar kanë bërë në seancë kërkesë për moskompetencë tokësore, por gjykata nuk e ka pranuar sepse çështja është pranuar për gjykim nga gjyqtari i seancës paraprake dhe Gjykata e Apelit që ka shqyrtuar vendimin e tij nuk ka konstatuar mungesë kompetence.

**6.42** Gjykata e Rrethit Gjiqësor Vlorë ka gjykuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit A. D. për veprat penale “falsifikim i dokumenteve”, “mashttrim” dhe “pastrim i produkteve të veprës penale”. Në përfundim të gjyimit subjekti, si përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Vlorë, ka kërkuar tërheqjen e akteve, veprim procedural ky i lejuar nga neni 377 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Rrethit Gjiqësor Vlorë ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit A. D. për shkak se fakti në ngarkim të tij nuk përbën vepër penale. Në arsyetimin e vendimit, kjo gjykatë shprehet se nga tërësia e kërkesës për gjykim të prokurorisë nuk identifikohet dokumenti i falsifikuar nga i pandehuri A. D., pra prokuroria nuk ka individualizuar objektin material të veprës penale. Gjithashtu, nga hetimet disavjeçare nuk ka rezultuar që i përfaqësuari t’i ketë njoftuar revokimin e prokurës me mjete të përshtatshme as përfaqësuesit A. D., as ndonjërit nga institucionet për të cilat i kishte dhënë prokurë përfaqësuesit. Rezultoi e provuar plotësisht se i pandehuri A. D. nuk ka ditur dhe nuk ka pasur mundësi të dinte se përfaqësuesi A. D. ka qenë në tejkallim të tagrave të përfaqësimit. Konflikti midis kallëzuesve dhe shtetasit A. D. është i natyrës civile dhe nuk përmban ndonjë element të veprës penale.

**6.43** Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë ankim ndaj këtij vendimi, i cili është ankimuar nga personat e interesuar në çështje, E. T. etj. dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.4.2022, e ka lënë në fuqi këtë vendim që ka marrë formë të prerë.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit që e ngarkojnë atë me përgjegjësi apo që tregojnë mangësi në aftësitë profesionale të tij.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Referuar analizës së raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar, trupi gjykues vlerëson se në vështirimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje serioze e të përsëritura të natyrës procedurale, gabime thelbësore apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e veprimeve hetimore dhe vlerësimit të çështjeve nga subjekti i rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuara nga ligji nr. 84/2016.

### **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve IV, V, VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Alfred Sali:

- a. Në lidhje me kriterin e pasurisë ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë.

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i tij dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara, duke rezultuar me një balancë financiare negative në shumën 8.707.775 lekë.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit Alfred Sali nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është *i aftë*, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.
- d. Në vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në pikat 1, 2, 3 dhe 5, në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/c të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Alfred Sali, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
  2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 22.7.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*